



RIINVEST
INSTITUTI PER HULUMTIME ZHVILLIMORE
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT RESEARCH

FORUMI EKONOMIK VJETOR

Zhvillimet ekonomike Kërcënimet nga kriza institucionale

NËNTOR, 2025



FORUMI EKONOMIK VJETOR

Zhvillimet ekonomike Kërcënimet nga kriza institucionale

PËRGATITUR NGA:

Alban Hashani – Drejtor Ekzekutiv, udhëheqës i projektit
Muhamet Mustafa – Këshilltar senior, koordinator i projektit
Alma Bajramaj
Benet Maloku
Erisa Kallaba
Gent Beqiri
Halim Mahmuti
Mentor Geci
Petrit Gashi
Tringë Shkodra
Valentin Toçi
Visar Vokrri

BOTUAR NGA:

INSTITUTI RIINVEST
Andrea Gropa Prishtinë 10000,
Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320;
www.riinvestinstitute.org

Këndvështrimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve. Instituti Riinvest merr përsipër përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e këtij raporti.

E drejta autoriale © 2025 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem riprodhimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa e cituar burimin.

Përmbajtja

SHKURTESAT	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME	8
HYRJE	10
1. RITJA EKONOMIKE DHE KONFIGURACIONI MAKROEKONOMIK	11
1.1 Konteksti global i rritjes ekonomike	12
1.2 Konteksti makroekonomik i Kosovës	13
1.3 Sfida demografike dhe ndikimi në rritje ekonomike	16
1.4 Sektori i jashtëm	17
1.5 Sektori financiar	21
1.6 Shpenzimet qeveritare – Buxheti	25
2 MJEDISI BIZNESOR	34
2.1 Barrierat kryesore në mjedisin biznesor 2025	35
2.2 Rregullativa ligjore dhe fiskale	36
2.3 Qasja në financa	36
2.4 Ekonomia informale dhe korrupsioni	36
2.5 Tregu i punës	37
2.6 Barrierat administrative dhe infrastruktura	37
2.7 Barrierat e brendshme	37
2.8 Liberalizimi i tregut të energjisë dhe mjedisi biznesor në Kosovë.....	37
3. EKSPORTET	41
3.1 Diversifikimi i eksporteve.....	43
3.2 Rrjetet dhe rëndësia e tyre në rritjen e eksporteve	48
3.3 Burimet njerëzore dhe teknologjike.....	49
3.4 Pengesat, faktorët e rritjes, dhe performanca institucionale	52
Referencat	61
Shtojcat	63

Shkurtesat

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ASHAK	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BE	Bashkimi Evropian
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Central European Free Trade Agreement
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
FTA	Free Trade Agreement
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci të Kredive
NMV	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
FEV	Forumi Ekonomik Vjetor
FEV25	Forumi Ekonomik Vjetor 2025
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
K&I	Kërkim dhe Inovacione
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
FPP	Modeli Makroekonomik për Kosovën
PVB	Produkti Vendor Bruto
FSHU	Furnizimi me Shërbim Universal
kWh	Kilovat-orë
GET	German Economic Team
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
ROA	Return on Assets
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
wiiw	Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare
ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Republikës së Kosovës

Lista e Tabelave

Tabela 1: Parashikimet e rritjes reale të PVB-së në vendet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2025 (në përqind).....	12
Tabela 2: Parashikimet për rritjen reale të PVB-së së Kosovës në vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026	14
Tabela 3: Bilanci tregtar i Kosovës (në miliona euro)	17
Tabela 4: Tregtia e mallrave (në miliona euro)	18
Tabela 5: Tregtia e shërbimeve (në miliona euro)	19
Tabela 6: Statistikat e sektorit të jashtëm dhe bilancit të pagesave	20
Tabela 7: Struktura e shpenzimeve qeveritare si përqindje e totalit.....	28
Tabela 8: Buxhetimi dhe realizimi i investimeve kapitale (milion euro)	30
Tabela 9: Korniza e shpenzimeve sektoriale në nivel qendror (milion euro)	31
Tabela 10: Barrierat në mjedisin biznesor	36
Tabela 11: Indikatorët e diversifikimit të eksporteve në Kosovë, 2015 - 2024	46
Tabela 12: Diversifikimi sipas produkteve eksportuese, HS 4-shifrorë, 2015 - 2024.....	47
Tabela 13: Diversifikimi në tregjet eksportuese, 2015 - 2024	48
Tabela 14: Diversifikimi nga perspektiva e bizneseve, 2022 - 2024	49
Tabela 15: Investime e eksportuesve dhe jo-eksportuesve në hulumtim dhe zhvillim.....	51

Lista e Figurave

Figura 1: Indikatorët e likuiditetit dhe raporti kredi/depozitë për bankat komerciale, periudha 2019-2025.....	21
Figura 2: Mbitërheqjet dhe linjat kreditore gjatë periudhës 2019-2024 (në milionë euro)	22
Figura 3: Rritja vjetore e kredive dhe depozitave gjatë periudhës 2020-2025 (në %)	23
Figura 4: Normat e interesit të kredive dhe depozitave, periudha 2019-2025, (në %)	24
Figura 5: Indikatorët e performancës së Fondeve Pensionale, analizë krahasuese Janar- Gusht 2024/25, (në %)	25
Figura 6: Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore (miliarda euro).....	26
Figura 7: Struktura e të ardhurave buxhetore	27
Figura 8: Struktura e shpenzimeve buxhetore	29
Figura 9: Struktura e borxhit shtetëror të Kosovës.....	32
Figura 10: Struktura e eksporteve sipas distancës me konsumatorin final.....	44
Figura 11: Kanalet e rrjetëzimit dhe qasja në tregjet eksporti	50
Figura 12: Zhvillimet teknologjike në bizneset eksportuese dhe jo-eksportuese.....	52
Figura 13: Pengesat kryesore për zgjerim në tregjet eksportuese	53
Figura 14: Faktorët e rritjes së eksporteve në tregjet ekzistuese	55
Figura 15: Arsyet e rënies së eksporteve në tregjet ekzistuese	56
Figura 16: Intensiteti i marrëdhënieve eksportuese me partnerët tregtar	57
Figura 17: Arsyet e tërheqjes nga tregjet e eksportit	58
Figura 18: Përceptimi i bizneseve eksportuese për përfitimet nga aranzhmanet tregtare ekzistuese	59
Figura 19: Reformat për lehtësim të tregtisë	60
Figura 20: Efikasiteti i institucioneve në procedurat kufitare	61

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME

Ky raport studimor është përgatitur për t'i shërbyer debatit në sesionin e sivjetmë të Forumit Ekonomik Vjetor të Institutit Riinvest (FEV25). Për të tretin vit me radhë, ky produkt i yni, i konceptuar dhe i "brenduar" që të jetë një nga debatet më të rëndësishme ekonomike për vlerësimin e zhvillimeve ekonomike në vend në ndërrim të viteve, po merr fizionominë e tij të synuar në Planin Strategjik të Institutit.

Trajektorja e rritjes ekonomike po tregon një ngadalësim të dukshëm, i ndikuar nga një sërë faktorësh që së bashku po krijojnë një efekt negativ të akumuluar. Ndryshimet në mjedisin global, të nxitura nga pasiguria e rritur për shkak të konflikteve të vazhdueshme, sidomos lufta në Ukrainë, si dhe sfidat që shoqërojnë tregtinë ndërkombëtare, veçanërisht për shkak të mosmarrëveshjeve midis akterëve më me ndikim, kanë ushtruar presion të konsiderueshëm mbi ekonominë e vogla. Ndërkaq edhe zhvillimet e brendshme në Kosovë po reflektojnë me peshë të madhe në këtë ngadalësim, duke u manifestuar në të gjithë sektorët ekonomikë: në sektorin real (përfshirë perceptimet dhe pritjet e komunitetit të biznesit), në sektorin e jashtëm (me thellimin e deficitit tregtar), në sektorin financiar (probleme në kreditim dhe likuiditet si për bizneset ashtu edhe për amvisëritë) dhe në atë qeveritar (buxheti karakterizohet nga një strukturë pavolitshme destinimesh dhe probleme serioze në zbatimin e tij).¹ Rritja e cilësisë së qeverisjes ekonomike nuk ka prodhuar rezultatet e domosdoshme; kjo pasqyrohet në normat e rritjes ndjeshëm më të ulëta sesa ato të planifikuara në buxhetet vjetore dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), e cila këtë vit nuk ka arritur as të përditësohet. E gjithë kjo është përkeqësuar me dështimet për krijimin e institucioneve të reja pas zgjedhjeve nacionale të shkurtit. Ky proces është kurrthuar në një dinamikë e servisuar nga një konflikt antagonistik midis partisë fituese relative të zgjedhjeve dhe partive të tjera më të mëdha në Kuvend. I gjithë ky proces, i kontestuar vazhdimisht në aspektin kushtetues e legal, po rezulton ta vërë në plan të parë ambicien për pushtet, të

përcjellë me një indiferencë të patolerueshme ndaj intereseve primare të vendit, duke mbajtur tashmë për nëntë muaj një situatë të paqartë.

Institucionet kryesore ndërkombëtare parashikojnë që rritja ekonomike për këtë vit dhe vitin e ardhshëm të jetë në intervalin 3.8–3.9 përqind. Duke u bazuar në të dhënat më të fundit nga sektorë të ndryshëm, Instituti Riinvest prognozohet se rritja do të jetë më e ngadalshme, në nivelin 3.6 përqind. Për dallim prej këtyre parashikimeve, Qeveria në detyrë, përkatësisht Ministria e Financave, me vlerësimet e saja parashikon ritme dukshëm më të larta të rritjes: 4.3 përqind për vitin 2025 dhe 4.9 përqind për vitin 2026. Këto vlerësime vazhdojnë prirjen e projeksioneve optimiste të Ministrisë, të cilat shpesh kanë rezultuar më të larta sesa rritjet e realizuara në vitet përkatëse. Buxheti i parashikuar për vitin 2026, i cili për arsytet e përmendura më lart nuk ka arritur të hyjë në procedura të Kuvendit, vazhdon trendin e rritjes së viteve të fundit. Megjithatë, ai trashëgon probleme të theksuara në strukturën dhe realizimin e investimeve kapitale, si dhe nivel të ulët financimi për arsimin, kërkimin shkencor dhe shëndetësinë. Nga ana tjetër, buxheti ngarkohet me transfere të tej-dimensionuara, sidomos kur vlerësohen nga aspekti i joefektivitetit të tyre dhe fakti se nuk arrijnë të krijojnë masën kritike për ndryshime cilësore në sektorët socialë më në nevojë, duke u shoqëruar gjithashtu me një kosto të lartë oportune. Në të gjithë këta sektorë të ndjeshëm dhe thelbësorë për rritjen e cilësisë së zhvillimit, Kosova mbetet dukshëm prapa vendeve të rajonit dhe kërkesave që imponon dinamika e procesit të integritimit në Bashkimin Evropian. Kjo situatë prodhon mangësi të theksuara në kapitalin intelektual dhe pasqyrohet drejtpërdrejt në produktivitetin e ulët të punës, i cili arrin në më pak se 40 përqind të mesatares së BE-së. Dobësitë në sektorin e investimeve, veçanërisht në investimet publike, pengojnë transformimin e nevojshëm strukturor dhe frenojnë ritmet e domosdoshme më të larta të rritjes ekonomike, të cilat janë thelbësore për të arritur

1 Për më shumë detaje, shih seksionet 1–3 dhe 1.5 të këtij raporti.

një konvergencë më domethënëse me Bashkimin Evropian.

Këtë vit, renditja e barrierave të perceptuara nga bizneset mbetet e ngjashme me vitet paraprake. Në krye qëndron mungesa e fuqisë punëtore dhe emigrimi, të pasuara nga kostot e larta të financimit. Mungesa e punëtorëve të kualifikuar dhe informaliteti vijojnë të jenë po ashtu ndër sfidat kryesore. Procedurat dhe ngarkesat administrative mbeten një barrierë e rëndësishme, edhe pse Kosova ka bërë përpime në uljen e barrës administrative dhe thjeshtimin e disa proceseve.

Këto barrierë pasohen nga problemet e furnizimit me energji, të cilat kanë rritur intensitetin, si dhe nga sfidat në zbatimin e kontratave lidhur me obligimin e rreth 1,200 bizneseve për të kaluar në tregun e liberalizuar të energjisë. Gjithashtu, në këtë grup të barrierave këtë vit ngrihet në renditje edhe jostabiliteti politik. Në fund të renditjes gjenden barrierat jotarifore në tregti, transporti dhe telekomunikimet, të cilat edhe pse më pak të theksuara, vazhdojnë të ndikojnë në mjedisin e biznesit.

Këtë vit, një theks i veçantë vendoset tek energjia, pasi kalmi në tregun e hapur ka sjellë rritje fillestare të çmimeve që në shumë raste kanë qenë më shumë se dyfish. Megjithatë, pritjet në treg sugjerojnë se këto çmime mund të stabilizohen në një rritje rreth 30 për qind në periudhën afatmesme. Ndërkohë, barra e kostove më të larta të energjisë nuk është e njëjtë për të gjitha sektorët: disa prej tyre përballen me ndikim shumë më të madh në konkurrueshmëri. Barra e kostos shtesë të energjisë (e shprehur si përqindje e vlerës së shtuar bruto) është më e larta në industrinë ushqimore, duke reflektuar ekspozimin e lartë energjetik të këtij sektori. Sektorë të tjerë prodhues, si makineritë, mineralet jo-metalike dhe metalet, përballen me barrë të ngjashme. Këta sektorë goditen dyfish: nga rritja direkte e çmimit të energjisë dhe nga rritja e kostove të inputeve që vetë kanë intensitet të lartë energjie. Problemi bëhet edhe më i madh kur këta sektorë kanë një rëndësi të veçantë edhe në aspektin e eksportit. Ndërkaq, shërbimet dhe bujqësia kanë ekspozim më të vogël, për shkak të intensitetit të ulët energjetik. Për këtë arsye, masat mbështetëse duhet të orientohen sidomos drejt atyre sektorëve që rrezikojnë të humbin pozicionin e tyre konkurrues si pasojë e kostove të shtuara të energjisë.

Pjesa e tretë e raportit, ajo tematike që trajton trendet, burimet dhe aftësitë konkurruese të bizneseve, bazohet gjithashtu në të dhëna primare të mbledhura përmes një ankete me rreth 300 biznese. Pjesa dërmuese e menaxherëve/pronarëve nga bizneset eksportuese kanë raportuar rritje të eksporteve këtë vit krahasuar me vitin paraprak. Sipas tyre, kjo rritje vjen si rezultat i rritjes së cilësisë së produkteve të eksportuara, konsolidimit të marrëdhënieve të qëndrueshme biznesore me partnerët tregtarë, si dhe çmimeve relativisht konkurruese që u mundësojnë të ruajnë pozicionin në treg. Në anën tjetër, një pjesë tjetër e bizneseve që kanë raportuar rënie të eksporteve theksojnë si arsye kryesore intensifikimin e konkurrencës në tregjet e jashtme dhe kostot e larta të prodhimit, të cilat po ashtu e dobësojnë aftësinë e tyre konkurruese. Një fenomen që mbetet shqetësues është fakti se më shumë se gjysma e eksportuesve nuk arrijnë të sigurojnë aranzhmane kontraktuale më gjatë se tri vite me partnerët e tyre. Kjo tregon një nivel të lartë pasigurie në marrëdhëniet tregtare, që kufizon mundësinë e planifikimit afatgjatë dhe investimeve në kapacitete të reja. Për më tepër, një e katërta e bizneseve mbështeten ende në dërgesa sporadike apo eksporte të njëhershme, gjë e cila shpërfaq një strukturë të brishtë të raporteve biznesore me partnerët tregtar dhe kufizon parashikueshmërinë e biznesit tek këto ndërmarrje. Kostot e larta të zgjerimit së bashku me vështirësitë për të depërtuar në tregje të reja, mbeten ndër pengesat kryesore që kufizojnë rritjen më të shpejtë të eksporteve. Nga ana strukturale, eksportet e Kosovës dominohen ende nga produktet e ndërmjetme pa ndonjë vlerë të lartë të shtuar - mallra që kalojnë të paktën një fazë përpunimi para se të arrijnë te konsumatori final. Kjo strukturë ka implikime të rëndësishme për pozicionimin e vendit në zinxhirët globalë të vlerës dhe për potencialin e krijimit të vlerës së shtuar në ekonomi.

Bazuar në të gjeturat e këtij Raporti rekomandohet sa vijon:

- Akterët politikë, por edhe shoqëria civile dhe qarqet intelektuale, duhet të kontribuojnë shumë më tepër në tejkalimin e ndeshjeve antagoniste të subjekteve politike, të cilat zhvillohen me primesa primitive dhe jashtë interesave të qytetarëve, duke dëmtuar pozitën ndërkombëtare të vendit. Në këtë kuptim, nevojitet tejkalim urgjent i vështirësive që po e mirëmbajnë vakumin institucional në vend.
- Mbetet më tutje një prioritet që Qeveria e Kosovës të krijojë një trupë kompetente të përbërë nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë për të hartuar një dokument afatgjatë me vizion, ambicie dhe zgjedhje të qarta politikash e masash, përmes të cilit tejkalohet në mënyrë efektive modeli aktual i rritjes ekonomike.
- Ngjashëm me rekomandimin e FEV 2024, duhet insistuar në ristrukturimin e shpenzimeve buxhetore në dobi të rritjes së ndjeshme të shpenzimeve dhe investimeve për arsim e edukim, shëndetësi dhe kërkime zhvillimore e inovacione. Duhet të synohen standardet e vendeve të rajonit dhe përshpejtimi i përafrimit me mesataren e investimeve qeveritare në këta sektorë në raport me PVB-në në BE. Po ashtu, nevojitet rishqyrtim dhe auditim i pakos së transfereve për të rritur masën kritike të intervenimeve tek grupet sociale më në nevojë dhe për të siguruar një kosto oportune të arsyeshme.
- Edhe më tutje mbetet prioritet i lartë që Qeveria duhet të analizojë thellësisht dobësitë kronike në realizimin e investimeve kapitale, sidomos investimeve nga klauzola e investimeve të mbështetura nga huatë e jashtme. Nevojitet rritje e përgjegjësisë së lidershit në ministri, agjenci dhe organizata të tjera buxhetore.
- I gjithë sektori i jashtëm duhet t'i nënshtrohet një rishikimi kritik e të detajuar për të zvogëluar deficitet, sidomos në këmbimin e mallrave. Duhet promovuar një sistem integral masash për nxitjen dhe lehtësimin e eksportit, eliminimin e barrierave të theksuara të evidentuara në pjesën e tretë të raportit dhe krijimin e një sistemi të integruar për rritjen e aftësisë konkurruese.
- Asociacionet e biznesit duhet të angazhohen me anëtarësinë e tyre për të rritur vetëdijen se investimet private – pra nga vetë bizneset – në kërkime zhvillimore dhe inovacione duhet të jenë pjesë e agjendës së tyre të përditshme, si një parakusht për ngritjen e kompetencave, rritjen e produktivitetit dhe forcimin e aftësisë konkurruese.
- Institucionet kërkimore dhe akademike duhet të krijojnë bashkëpunim sistematik me sektorin privat. Për këtë, është e nevojshme të avancohet kuadri ligjor dhe nënligjor, sidomos në universitetet publike.
- Rekomandohet përmirësimi i sistemit të grumbullimit dhe analizës së informacionit statistikor, me fokus të veçantë në investimet e sektorit privat, për të siguruar të dhëna më të sakta dhe të detajuara që mbështesin vendimarrjen strategjike dhe zbatimin efektiv të politikave ekonomike.

Ky raport studimor është përgatitur për t'i shërbyer debatit në sesionin e sivjetëm të Forumit Ekonomik Vjetor 2025 (FEV25), i cili pason sesionet e dy viteve të kaluar dhe synohet të vazhdojë të jetë tradicional. Forumi Ekonomik është iniciuar për të siguruar një debat të angazhuar dhe produktiv lidhur me ecuritë ekonomike, problemet prezente gjatë vitit kalendarik dhe pritjet për vitin e ri. FEV siguron një audiencë të përbërë nga aktet më përgjegjës dhe të interesuar për zhvillimet ekonomike, duke përfshirë përfaqësues të institucioneve publike, asociacioneve të biznesit, udhëheqës ekzekutivë të ndërmarrjeve, ekspertë nga institucionet financiare dhe përfaqësues të qarqeve kërkimore e akademike. Forumi i Institutit Riinvest synon të konsolidohet si një ngjarje e shënuar dhe me vizibilitet të lartë për zhvillimet ekonomike në vend. Në përgatitje të FEV25, Instituti Riinvest ka hartuar një raport studimor i cili përfshin:

- a. problemet prezente lidhur me dinamikën dhe cilësinë e rritjes ekonomike, pritjet për të ardhmen, sidomos për vitin vijues, si dhe politikat ekonomike. Raporti jep përgjigje pse rritja ekonomike posfidohet nga mjedisi global, por edhe më shumë nga konteksti i brendshëm, i cili mbetet shumësh-tresor dhe i ndërlikuar.
- b. evoluimin e mjedisit biznesor dhe intensitetin e barrierave të caktuara në këtë mjedis;
- c. një analizë më të detajuar të eksporteve nga Kosova, si temë speciale e FEV25, përfshirë vëllimin, strukturën dhe efikasitetin e tyre, duke ofruar rekomandime për politikat ekonomike në fushën e nxitjes së eksportit.

Ky raport është përgatitur duke analizuar studimet e Institutit Riinvest, Programin Qeveritar dhe reflektimin e tij në Buxhetin për vitin 2025, realizimin buxhetor dhe draft-buxhetin e vitit 2026, raportet e konsumit buxhetor, kumtesat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për ecuritë sektoriale gjatë vitit 2025, raportet mujore dhe vjetore të BQK-së, si dhe raportet e fundit të FMN-së, Bankës Botërore, BERZH-it, BE-së dhe prognozot e wiiw-it. Përveç këtyre burimeve, është zhvilluar një anketë me afro 300 biznese (gjatë periudhës shtator-tetor 2025), e përqendruar në aktivitetet eksportuese dhe barrierat në mjedisin biznesor. Studimi është realizuar mbi bazën e një mostre të rastësishme standarde.

Raporti është lidhet gjithashtu edhe me aktivitetet e "Forumit 2015," i cili që nga viti 2023 zhvillon aktivitetet si një program dhe platformë debatesh për integrimin euro-atlantik të Kosovës në kuadër të Institutit Riinvest.

Konstatimet e prezantuara përfaqësojnë pikëpamjet e ekipit kërkimor, përkatësisht të Institutit Riinvest dhe jo domosdoshmërisht të akterëve të tjerë të përfshirë në realizimin e këtij projekti.

**RRITJA EKONOMIKE
DHE KONFIGURACIONI
MAKROEKONOMIK**



1.1 Konteksti global i rritjes ekonomike

Një sërë krizash të njëpasnjëshme, që nga pandemia e lufta në Ukrainë dhe tensionet tregtare midis ekonomive të mëdha, ndikuan që ekonomia botërore të ballafaqohet me një fazë të re ngadalësimi dhe fragmentimi strukturor. Banka Botërore (2025a), parashikon që rritja globale të bjerë në 2.3 përqind, ritmi më i ulët që nga viti 2008, përjashtuar vitin e recesionit gjatë pandemisë. Fondi Monetar Ndërkombëtar FMN (2025) ka një vlerësim pak më optimist, duke sugjeruar që rritja globale do të jetë rreth 3 përqind, por thekson se pa rritje të produktivitetit dhe stabilitet më të madh politik, perspektiva mbetet e zbehtë. Parashikimet për vitin 2026 mbesin pak a shumë në këtë ritëm të ngadalësuar të rritjes (3.1 përqind) në krahasim me vitin 2024 (3.6 përqind), ndërsa ekonomitë emergjente rreth 4 përqind. Inflacioni pritet të bie nga 4.2 në 3.7 në rrafshin global i përcjellë, me variacione të shprehura: Shtetet e Bashkuara përballen me inflacion mbi objektiv dhe me rreziqe në rritje, ndërsa pjesa më e madhe e botës pritet të ketë presion më të zbehtë të çmimeve (FMN, 2025).

Në këto trende duket së reflektohen dhe normat më të larta reale të interesit dhe plakja demografike OECD (2025). Rritja tek ekonomitë në zhvillim pritet të arrij rreth 4 përqind, por kjo nuk mjafton për të përshpejtuar konvergjencën me vendet e zhvilluara. Edhe Banka Botërore (2025a) vëren se inflacioni global është në rënie, por mbetet një kërcënim latent, sidomos në ekonomitë në zhvillim, ku çmimet e ushqimeve dhe energjisë mbeten të paqëndrueshme.

Sipas McKinsey (tetor 2025), drejtuesit e kompanive në nivel global e konsiderojnë pasigurinë tregtare dhe gjeopolitike si kërcënimet kryesore për investimet dhe rritjen afatmesme. Kjo pasiguri ka kontribuar në një rënie të vazhdueshme të investimeve të jashtme në ekonomitë në zhvillim, të cilat kanë rënë ndjeshëm krahasuar me nivelet e tyre më të larta para krizës financiare globale (Banka Botërore, 2025a).

Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare wiiw (2025) parashikon se rajoni i vendeve të Ballkanit Perëndimor do të ketë rritje mesatare prej 2.5 përqind në vitin 2025 dhe 3-4, përqind në 2026. Ngjashëm me këtë,

● Tabela 1. Parashikimet e rritjes reale të PVB-së në vendet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2025 (në përqind)

	BERZH	wiiw	FMN	Banka Botërore
Kosovë	3.9 %	3.9 %	3.9 %	3.8 %
Shqipëria	3.5 %	3.5 %	3.4 %	3.7 %
Bosnjë dhe Hercegovinë	2.0 %	2.2 %	2.4 %	2.6 %
Mali i Zi	3.1 %	3.4 %	3.2 %	3.3 %
Maqedonia e Veriut	3.0 %	3.0 %	3.4 %	3.1 %
Serbi	2.5 %	2.0 %	2.4 %	2.8 %

Burimi: Përpunuar nga Instituti Riinvest (2025), bazuar në të dhënat më të reja nga BERZH (2025), wiiw (2025), FMN (2025) dhe Banka Botërore (2025b).

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim BERZH (2025) thekson se ekonomitë në të cilat operon kjo bankë, përfshirë Evropën Qendrore, Juglindore dhe Ballkanin Perëndimor, po përjetojnë ngadalësim të dukshëm të konsumit dhe investimeve, ndërsa inflacioni është zbutur porse niveli i tij mbetet ende mbi objektivat e këtyre vendeve. Sipas BERZH-it, Ballkani Perëndimor pritet të rritet mesatarisht me 2.7 përqind në 2025 (nga 3.6 përqind në 2024), dhe vetëm 3.2 përqind në vitin 2026. Në të njëjtën kohë, BERZH (2025) paralajmëron se mungesa e kapitalit privat po kufizon investimet në teknologji, inovacion dhe tranzicionin e gjelbër. Kjo ka të bëjë veçanërisht në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku nevojitet mbështetje më e fortë për sektorin prodhues dhe infrastrukturën e fizike e cila mundëson tregtinë rajonale dhe qasjen në tregje ndërkombëtare.

Ekziston frika se, një përshkallëzim i tensioneve tregtare apo konflikteve gjeopolitike mund të dobësojë më tej rritjen globale dhe të rrisë pasigurinë financiare. Për vende të vogla e të hapura si Kosova, këto zhvillime nënkuptojnë një mjedis të jashtëm më të pavolitshtëm që karakterizohet me kërkesë të jashtme të zbehur për eksporte, rrjedhë të ngadalësuar të investimeve të jashtme dhe remitancave dhe konkurrencë më të madhe për kapital njerëzor me ndikim në stimulimin e emigrimit të profesionistëve. Kjo e bën të domosdoshme që rritja ekonomike të mbështetet gjithnjë e më shumë në investime në kapitalin njerëzor, demotivimin e emigrimit, investime në inovacion dhe përmirësimin e stabilitetit institucional e sidomos në qeverisjen e përmirësuar ekonomike.

1.2 Konteksti makroekonomik i Kosovës

Pas procesit të konsolidimit të ritmeve të rritjes në nivelin para pandemisë në vitin 2025, ekonomia e Kosovës ka hyrë në një fazë ngadalësimi të lehtë. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK, 2025), rritja reale e PVB-së arriti 2.83 përqind në tremujorin e parë dhe 4.58 përqind në tremujorin e dytë, duke reflektuar një ritëm më të moderuar e me probleme sa i përket shfrytëzimit të hapësirës deri tek mundësitë potenciale të zgjerimit ekonomik. Ky ngadalësim lidhet kryesisht me përkeqësimin e sektorit të

jashtëm. Ndërmjet tremujorëve të parë dhe të dytë të viteve 2024 dhe 2025, deficitit tregtar u rrit me 16.6 përqind ndikuar nga të dy drejtimet - rënia e eksporteve të mallrave me rreth 4.1 përqind dhe rritja e importeve të mallrave me afro 16.5 përqind. Ky zhvillim tregon se rritja e kërkesës së brendshme, veçanërisht për konsum dhe investime, po shoqërohet me rritje të fortë të importeve, ndërkohë që kapacitetet eksportuese mbeten të kufizuara. Si rezultat, kontributi i sektorit të jashtëm në ritmin e rritjes ka qenë negativ dhe sikurse edhe më parë po frenon ndikimin pozitiv të efekteve të komponentëve të tjerë të PVB-së. Kjo çështje është trajtuar më gjerësisht në kapitullin e tretë.

Ngjashëm me lëvizjet globale, parashikimet e institucioneve ndërkombëtare prognozojnë një ngadalësim të lehtë të rritjes ekonomike edhe në Kosovë. Instituti Riinvest, për herë të parë, ka përgatitur një parashikim të vetin makroekonomik, duke vlerësuar se rritja reale e PVB-së do të jetë 3.6 përqind.² Prognoza jonë është më e ultë nga parashikimet e disa institucioneve ndërkombëtare dhe në nivel dukshëm më të ulët se projeksioni i Ministrisë së Financave me draftin e buxhetit. Projeksioni ynë, duke u bazuar në të dhëna më të reja, përfshirë edhe të dhënat nëntë mujore vlerëson se mund të ketë një ritëm më të ngadalshëm të rritjes së investimeve në përgjithësi (formimi i kapitalit bruto) dhe gjithashtu dhe rënien normës reale të rritjes së konsumit të ndikuar nga rritja e normave të interesit, të rënies së fuqisë blerëse dhe restriksioneve që po zbatojnë bankat në emetimin e kredive (shih detajet më poshtë në seksionet 1.3-1.5 të këtij raporti). Kësaj i shtohen edhe rrethanat e tjera lidhur me probleme sidomos në sektorin e jashtëm, në atë financiar dhe aq më shumë ato në procesin buxhetor dhe politikat dhe menaxhimin e buxhetit. Megjithatë, përkundër variacioneve të këtyre parashikimeve gjithsesi ato ndikojnë se rritja ekonomike mbetet e pamjaftueshme për të adresuar boshllëqet dhe shpërpjesëtimet strukturore e të tjera në konfiguracionin makroekonomik si dhe për të siguruar një proces më të shpejtë konvergjence me ekonomitë e zhvilluara të Bashkimit Evropian.

2 Metodologjia e përdorur për hartimin e projeksioneve makroekonomike i referohet modelit makroekonomik të përshkruar në mënyrë më të detajuar në Shtojcën 1.

● **Tabela 2.** Parashikimet për rritjen reale të PVB-së së Kosovës në vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026

	Rritja e parashikuar (përqind)	
	2025	2026
Instituti Riinvest	3.6	3.6 ↔
Banka Botërore	3.8	3.8 ↔
FMN	3.9	4.0 ↑
wiiw	3.9	3.8 ↓
BERZH	3.9	3.9 ↔
Projeksioni sipas Draft Buxhetit të vitit 2026 (MF)	4.3	4.9 ↑

Burimi: Riinvest (2025); BERZH (2025), wiiw (2025), FMN (2025) dhe Banka Botërore (2025b), Drafti i Buxhetit të Kosovës (Ministria e Financave).

Institucionet ndërkombëtare dhe Instituti Riinvest parashi-kojnë një rritje të ngjashme ekonomike edhe për vitin 2026. Kjo merr ne konsideratë karakteristikat kryesore të mjedisit global dhe vendor e që reflektohen tek kushtet frenuese të aktivitetit ekonomik të cilat pritet të mbesin pak a shumë të ngjashme, me një risk përkeqësimi potencial që vjen veçmas nga sektori i jashtëm (shih pjesën 1.3.).³ Për dallim nga këto Ministria e Financave në vlerësimet që e shoqërojnë Draftin e Buxhetit të përpiluar, por për dallim nga vitet e tjera ende nuk është në shqyrtim nga Kuvendi i Kosovës, përvijon një rritje ekonomike optimiste, dukshëm më të lartë prej 4.3 përqind në 2025 dhe 4.9 përqind në vitin 2026. Projektsonet e dizajnuara në këtë dokument përveçse vështirë tejkalojnë testin e realitetit nuk duket të bëjnë ndonjë kthesë që krijon parakushte për rritje më domethënëse ekonomike. Buxheti

mbetet ende me mungesa serioze sa i përket nivelit të destinimeve për arsim dhe edukim, kërkime dhe inovacione dhe shëndetësi, të gjithë këta faktorë përcaktues për fuqinë absorbuese të ekonomisë vendore për zhvillim dhe rritje. Subvencionet dhe transferet e hipertrofuara me një pjesëmarrje shumë të lartë se sa kategoritë e tjera me një pjesëmarrje prej 34 përqind në shpenzimet buxhetore, mbesin jo selektive dhe pa krijuar një masë kritike për ndryshim pozitiv edhe tek vet përfituesit e tyre dhe me një kosto të lartë oportune. Pikërisht përmirësimi i këtij raporti midis tyre dhe tre sektorëve të përmendur mbetet i domosdoshëm për një funksion më frutdhënës të politikave buxhetore jo vetëm në mbështetjen e faktorëve cilësor të zhvillimit por edhe për krijimin e kushteve me efektive në barazinë sociale dhe reduktimin e mëtejme të varfërisë.⁴

3 Kërkesa vendore, investimet publike dhe eksporti i shërbimeve mbeten nxitësit kryesorë të rritjes ekonomike, por nga ana tjetër rreziqet që lidhen me problemet në politikë dhe konsolidimin institucional, inflacionin dhe bilancin tregtar vazhdojnë të jenë kërcënuese (wiiw, 2025). Ngjashëm, Banka Botërore (2025b) vëren se rreziqet ndaj parashikimeve të rritjes mbeten të larta për shkak të jofunksionalitetit institucional, i cili ngadalëson agjendën e reformave strukturore dhe qasjen në fondet e jashtme, përfshirë edhe Planin e Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor. Po ashtu, theksohet se emigrimi i vazhdueshëm ka ndikim negativ, duke vepruar si frenues i rritjes ekonomike.

4 Një nga shembujt tipik i intervenimit horizontal dhe jo selektiv për te targetuar segmentet e popullatës në nevojë është vendimi Qeverisë për intervenim prej 26 milion Eurosh në kohë të fushatës zgjedhore (pagesat nga 100 euro për secilin student). Me te drejtë shtrohet pyetja cila është kostoja oportune e këtij vendimi në krahasim me investimin e tyre në projekte arsimor, shëndetësore ose në kërkime dhe inovacione?

Pas një periudhe stabilizimi gjatë vitit 2024, inflacioni po rritet sërish duke arritur 4.7 përqind në shtator, si pasojë e rritjes së çmimeve të ushqimeve, pijeve, energjisë elektrike dhe shërbimeve, të cilat kanë shtuar presion mbi koston e jetesës (ASK, 2025). Sipas German Economic Team (2025a), me liberalizimin e tregut të energjisë, bizneset që kalojnë në tregun e hapur pritet të përballen me çmime rreth 70 përqind më të larta se tarifat e rregulluara, duke rritur ndjeshëm kostot e prodhimit dhe të shërbimeve. Kjo pritet të ndikojë veçanërisht në aftësinë konkurruese dhe rezultatet financiare të industrisë ushqimore, sektorin e shërbimeve dhe bujqësinë, të cilat janë më të ekspozuara ndaj kostove të energjisë, me një ndikim negativ edhe sa i përket eksportit. Paralelisht me këtë Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) miratoi një rritje prej 16.1 përqind të tarifave të rregulluara për konsumatorët e shërbimit universal, e cila ndikon drejtpërdrejt në çmimet përfundimtare të konsumit dhe ushtron presione shtesë mbi inflacionin dhe potencialisht edhe me reduktimin e fuqisë blerëse përkatësisht konsumit.⁵

Rritja ekonomike në Kosovë vazhdon të mos përkthehet në krijimin e mjaftueshëm të vendeve të reja të punës, duke treguar natyrën jo-përfshirëse të modelit aktual të zhvillimit. Siç kemi theksuar në raportet tona për FEV 2023 dhe 2024, ky model mbështetet kryesisht në konsum të ushqyer nga importi dhe mungesën e politikave aktive për rritjen e produktivitetit. Ende nuk ekziston një paketë koherente politike që mbështet faktorët cilësorë të zhvillimit, veçanërisht lidhjen ndërmjet ekonomisë kombëtare dhe sektorit të biznesit përmes investimeve në kërkim-zhvillim dhe inovacion.⁶

Ky është një defekt sistemik i modelit aktual ekonomik, i cili funksionon në një qark vicioz të konsumit të mbështetur nga importet. Këtë e kemi argumentuar gjerësisht në raportet e Forumin Ekonomik Vjetor të viteve 2023 dhe 2024.⁷ Fatkeqësisht, nuk vërehen ndryshime domethënëse në politikat buxhetore apo ekonomike.⁸

Edhe pse Programi Kombëtar i Kërkimeve Shkencore u miratua në vitin 2023, zbatimi i tij nuk ka filluar për shkak të mosrespektimit të obligimit ligjor për financimin prej 0.7% të Buxhetit. Aktualisht, investimet në kërkim-zhvillim vlerësohen vetëm rreth 0.1–0.2% të PVB-së — shumë më pak se mesatarja e Ballkanit Perëndimor (0.5%) dhe larg mesatares së BE-së (rreth 1.2%).⁹ Si rezultat, produktiviteti i punës në Kosovë mbetet i ulët, me vlerën e një ore pune rreth 26 dollarë, që përfaqëson më pak se 40% të mesatares evropiane.¹⁰

Pagat reale u rritën me 10.3 përqind gjatë vitit 2024, të nxitura nga rritja e pagës minimale dhe rritjet në sektorin publik. Megjithatë tregu i punës mbeti i ngurtë: punësimi formal u rrit vetëm me 1.4 përqind në gjysmën e parë të vitit 2025 (Banka Botërore, 2025b). Kjo tregon se rritja mbetet e përqendruar në sektorë me produktivitet të ulët, si tregtia, ndërtimtaria dhe shërbimet me vlerë të ultë shtuese, ku krijimi i vendeve të punës është i kufizuar. Sektorët e përmendur karakterizohen ende me nivel më të lartë të informalitetit. Ndërkohë, sektorët me potencial më të lartë të punësimit dhe produktiviteti, sikurse sektorët përpunues merr vlerë të lartë shtuese dhe teknologjia e informacionit, kanë peshë të vogël në strukturën ekonomike.

Pjesëmarrja e grave dhe të rinjve në tregun e punës mbetet ndër më të ulëtat në rajon, ndërsa mospërputhja mes ofertës dhe kërkesës për aftësi po thellohet, duke reflektuar boshllëqet në sistemin arsimor dhe emigrimin e fuqisë punëtore të kualifikuar. Në këtë mënyrë, rritja ekonomike nuk po reflektohet / shprehet në rritje të mirëqenies nëpërmjet punësimit cilësor. Kjo e bën tejet urgjent transformimin strukturor të ekonomisë së Kosovës.

Nga janari deri në korrik të vitit 2025, në Kosovë janë regjistruar 7,957 biznese të reja, krahasuar me 7,111 në të njëjtën periudhë të vitit 2024, një rritje prej rreth 12 përqind (ASK, 2025). Ky zhvillim sinjalizon një rritje të lehtë të ndërmarrësisë. Megjithatë, struktura sektoriale mbetet e pandryshuar: mbi 40 përqind e bizneseve të reja janë në tregti, ndërsa ndër-

5 Kjo temë do të analizohet në mënyrë më të detajuar në Kapitullin II, në kuadër të diskutimit për mjedisin biznesor.

6 Instituti Riinvest (2023b). Sektori i Kërkimeve dhe inovacioneve nga prizma e punëtorëve kërkimor dhe inovativ.

7 Instituti Riinvest (2024) Tejkalmi i kurthit të rritjes së pamjaftueshme dhe rritja e efikasitetit të investimeve (FEV2024); dhe (2023) Një Model i ri për rritjen e qëndrueshme ekonomike – dinamika e tregut të punës, sfidat aktuale dhe të ardhshme (FEV2023).

8 Shih Drafti Buxhetit për vitin 2026 të përpiluar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës.

9 Instituti Riinvest (2025b) Zhvillimet në kërkimet shkencore dhe inovacione 2023-2025

10 OECD (2025) Tabela e konvergjencës ekonomike për Ballkanin Perëndimor.

timtaria dhe shërbimet përbëjnë rreth një të katërtën e totalit. Sektori i prodhimit zë vetëm rreth 13 përqind, ndonëse shënoi një rritje të lehtë. Kjo tregon se, pavarësisht rritjes në numër, ndërmarrësia e re mbetet e përqendruar në sektorë me produktivitet të ulët, duke e bërë transformimin strukturor të ekonomisë të ngadalshëm dhe të varur nga sektorë që krijojnë pak vlerë të shtuar dhe punësim të kufizuar.

Pas zgjedhjeve të parakohshme të mbajtura në shkurt të vitit 2025, procesi i konstituimit të Kuvendit dhe formimit të qeverisë së re është zgjatur përgjatë gjithë muajve pasues, duke krijuar një periudhë pasigurie politike dhe institucionale. Kjo ka ndikuar jo vetëm në ritmin e zbatimit të politikave publike, por edhe në besimin e investorëve dhe biznesit privat, i cili mbetet i ndjeshëm ndaj paqëndrueshmërisë politike. Duke e nënvizuar këtë problem edhe Banka Botërore (2025b), thekson se ky vakum institucional mund të vonojë realizimin e investimeve publike dhe private, si dhe të ngadalësojë reformat strukturore, përfshirë ato që lidhen me Planin e Rritjes së BE-së, i cili kërkon koordinim të ngushtë ndërinstitutional. Vonesat në vendimmarrje kanë gjasa të shtyjnë zbatimin e projekteve në infrastrukturë, energji dhe digjitalizim, fusha që janë thelbësore për rritjen afatgjatë. Në këtë kuptim, stabiliteti institucional mbetet një parakusht për ruajtjen e ritmit të rritjes ekonomike dhe zbatimin efektiv të agjendës së reformave. Në vend të një marrëveshje e konsensusi bazik dhe uljen e tensioneve politike, situata ka ardhur duke u përkeqësuar viteve të fundit dhe kjo po reflektohet në lloj paralize dhe legjitimiteti të kontesuar rreth ekzekutivit të vendit e pasqyrohet me ngecjen në formimin e Qeverisë së re dhe një proces buxhetor i kontestuar në aspektin legal dhe procedural që rrezikon funksionimin normal të funksioneve ekonomike dhe shërbimeve publike në vend.

1.3 Sfida demografike dhe ndikimi në rritje ekonomike

Kosova me një ritëm të sforcuar po humb përparësitë e saj të lidhur me dividendin demografike. Kjo po shndërrohet në një nga sfidat më të mëdha strukturore të zhvillimit ekonomik të

Kosovës. Sipas të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2024, popullsia rezidente është tkurrur me mbi 15 përqind krahasuar me vitin 2011, si rezultat i rënies së lindshmërisë dhe migrimit të vazhdueshëm (ASK, 2025). Përbërja e popullsisë po ndryshon ndjeshëm: numri i të rinjve ka rënë me rreth 20 përqind, ndërsa grupmoshat mbi 55 vjeç po rriten me ritme të shpejta. Ky ndryshim i strukturës demografike po krijon presione të reja mbi forcën punëtore, kontributet fiskale dhe sistemet e pensioneve dhe shëndetësisë, duke e bërë rritjen ekonomike më të brishtë.

Sipas Bruegel (2025), plakja e popullsisë është bërë tashmë një nga faktorët kryesorë që frenon rritjen e PVB-së në Evropë, përmes uljes së produktivitetit, investimeve dhe inovacionit. Në Kosovë, kjo tendencë është veçanërisht problematike sepse ndodh në mungesë të një baze të qëndrueshme të kapitalit njerëzor¹¹: pjesëmarrja e grave në tregun e punës mbetet e ulët (rreth 25 përqind), ndërsa emigrimi i të rinjve të kualifikuar po e shteron më tej kapitalin njerëzor. Ky kombinim krijon një cikël të dobët zhvillimor, ku rënia e popullsisë aktive dhe mungesa e investimeve në arsim e aftësim profesional pengojnë rritjen e produktivitetit dhe e mbajnë ekonominë të varur nga remitancat.

Ndonëse mungesa e fuqisë punëtore mund të ketë efekte pozitive në disa vende të Ballkanit Perëndimor si një presion për pagave dhe nxitje e automatizimit e digjitalizimit të prodhimit.¹² Megjithatë, në rastin e Kosovës, ky efekt mbetet i kufizuar për shkak të kapaciteteve të ulëta teknologjike dhe institucionale dhe siç u theksua më lartë, mungesës së investimeve në kërkim dhe zhvillim (R&I), si dhe strukturës së ekonomisë e cila dominohet nga sektorë me produktivitet të ulët. Si pasojë, mungesa e fuqisë punëtore nuk po funksionon si katalizator për inovacion dhe efikasitet, por po ndikon kryesisht në rritjen e kostove të prodhimit dhe në vështirësitë e bizneseve për të zgjeruar aktivitetin.

Në këtë kontekst, migrimi i vazhdueshëm mbetet një faktor që përkeqëson më tej dinamikën demografike dhe ekonomike. Ndërkaq roli i remitancave është në pjesën më të madhe është mbështetës i konsumit që bazohet në import. Largimi i popullsisë aktive ul potencialin e rritjes afatgjatë

11 Banka Botërore projektton një ndryshim brengosës të rënies së pjesëmarrjes së popullsisë së re në popullsinë e përgjithshme 18 vjet dhe atë një zvogëlim të përqindjes së pjesëmarrjes për 37% për moshat 0-4 vjet, 49% 7-12 dhe 34% të atyre 13-18 vjet (Tetor 2025).

12 Holzner (2025) argumenton se në disa vende të Ballkanit Perëndimor, tkurrja demografike po sjell efekte paradoksalisht pozitive: mungesa e punëtorëve po nxit rritjen e pagave dhe konsumit të brendshëm, ndërsa njëkohësisht po e bën më të leverdishëm investimin në automatizim dhe robotizim.

dhe e bën vendin më të varur nga të ardhurat e jashtme. Për të përmbysur këto trende, Banka Botërore (2025b) sugjeron që Kosova duhet të rrisë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, të zhvillojë politika të kujdesit të përballueshëm për fëmijët dhe të forcojë programet për rikthimin dhe riintegrimin e diasporës së kualifikuar.

Nëse këto sfida nuk adresohen me politika të qëndrueshme dhe investime në kapitalin njerëzor, plakja dhe emigrimi mund të kthehen në një pengesë të vazhdueshme për konvergjencën e Kosovës me Bashkimin Evropian, duke e mbajtur vendin në një trajektore të rritjes së ngadalshme dhe të pabarabartë.

1.4 Sektori i jashtëm

Sektori i jashtëm i Kosovës mbeti nën presion të konsiderueshëm gjatë vitit 2025, duke reflektuar si dobësitë strukturore të brendshme që ndikojnë produktivitetin e punës dhe poashtu edhe pasiguritë e rritura në mjedisin global. Të dhënat tregojnë se, ndonëse eksportet e mallrave dhe shërbimeve shënuan rritje prej rreth dhjetë përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (nga 2.3 në 2.5 miliardë euro), kjo nuk mjaftoi për të kompensuar rritjen më të shpejtë të importeve, të cilat u rritën për rreth 14 përqind (nga 4.3 në 4.9 miliardë euro) (Tabela 3). Si rezultat, deficitit tregtar u thellua me rreth 18 përqind, duke arritur në 2.38 miliardë euro në periudhën janar–korrik 2025, e shoqëruar me zvogëlimin e te importit me eksporte nga 15 përqind në 13 %.

● **Tabela 3.** Eksporti dhe importi i shërbimeve ndër vite (në miliona euro)

Viti	Eksport	Import	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e eksportit me import (%)
2019	2,068	3,982	-1,914	52
2020	1,470	3,651	-2,181	40
2021	2,659	5,191	-2,532	51
2022	3,435	6,346	-2,911	54
2023	3,837	6,806	-2,969	56
2024	4,309	7,945	-3,636	54
Janar - Korrik 2024	2,296	4,320	-2,024	53
Janar – Korrik 2025	2,526	4,909	-2,383	51

Burimi: ASK dhe BQK (2025)

● **Tabela 4.** Tregtia e mallrave (në miliona euro)

Viti	Eksport	Import	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e eksportit me import %
2019	393	3,233	-2,840	12.2
2020	475	3,048	-2,573	15.6
2021	753	4,320	-3,567	17.4
2022	932	5,219	-4,287	17.9
2023	871	5,469	-4,598	15.9
2024	944	6,371	-5,427	14.8
Janar - Shtator 2024	690	4,555	-3,865	15.1
Janar – Shtator 2025	683	5,232	-4,549	13.1

Burimi: ASK (2025)

Gjatë nëntëmuorit të parë të vitit 2025, tregtia e mallrave ka vazhduar të shënojë disbalancë të thellë, me një rritje të dukshme të importeve dhe një rënie të lehtë të eksporteve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Sipas të dhënave të ASK-së, eksportet arritën në 683 milionë euro, krahasuar me 690 milionë euro në janar–shtator 2024, që nënkupton një tkurrje prej rreth një përqind (Tabela 4). Në anën tjetër, importet u rritën ndjeshëm me një rritje prej afërsisht 15 përqind. Si rezultat, deficitit tregtar u thellua ndjeshëm, duke arritur në –4.55 miliardë euro, nga –3.86 miliardë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2024. Po ashtu, mbulueshmëria e importeve me eksporte ka rënë nga 15.1 përqind në 13.1 përqind, duke shënuar nivelin më të ulët të dekadës së fundit.

Shërbimet, në anën tjetër, zbusin pjesërisht bilancin e llogarisë rrjedhëse. Gjatë shtatë muajve të parë të vitit 2025, bilanci pozitiv tregtar i shërbimeve arriti në 1.1 miliardë euro, që përfaqëson një rritje prej 22 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (Tabela 5). Sipas të dhënave të BQK-së, eksporti i shërbimeve arriti në dy miliardë euro deri në korrik 2025, nga 1.77 miliardë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2024, që përfaqëson një rritje prej rreth 13 përqind. Ndërkohë, importi i shërbimeve u rrit në mënyrë më të moderuar – apo rreth 4.5 përqind më shumë se një vit më parë.

● **Tabela 5.** Tregtia e shërbimeve (në miliona euro)

Viti	Eksporti i shërbimeve	Importi i shërbimeve
2019	1,675	749
2020	995	603
2021	1,906	871
2022	2,503	1,127
2023	2,966	1,337
2024	3,365	1,574
Janar – Korrik 2024	1,767	855
Janar – Korrik 2025	2005	894

Burimi: BQK (2025)

Ky zgjerim është rezultat i një kombinimi faktorësh, ku shpenzimet e diasporës në vend gjatë sezonit turistik vazhdojnë të luajnë rolin kryesor, por gjithashtu ndikojnë edhe rritja e numrit të udhëtarëve dhe fluturimeve. Në veçanti, eksporti i shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit vazhdojnë kenë rritje. Vetëm gjatë kësaj periudhe, eksportet në këtë kategori janë rritur me 19 për qind, duke arritur në 218 milionë euro deri në korrik 2025

Dërgesat nga diaspora mbeten një shtyllë e fortë e sektorit të jashtëm të Kosovës, megjithëse si pjesë e PVB-së pritet të shënojnë një ngadalësim të dukshëm gjatë vitit 2025. Sipas Bankës Botërore (2025b), Kosova – një nga përfitueset më të mëdha të remitencave në rajon – pritet të ketë ngadalësimin më të theksuar të flukseve, me një rënie prej rreth 1 pikë përqindjeje në PVB-së gjatë vitit 2025. Kjo pasqyron ndikimin e ngadalësimit ekonomik në vendet pritëse të diasporës, sidomos në Gjermani dhe Zvicër, si dhe efektet e inflacionit

të vazhdueshëm që ka reduktuar fuqinë reale e të ardhurave të emigrantëve.

Megjithatë, të dhënat e tetëmujorit të parë të vitit 2025 tregojnë një rritje modeste, por të qëndrueshme në terma nominalë, çka tregon se remitencat vazhdojnë të luajnë rol stabilizues në sektorin e jashtëm. Deri në fund të gushtit, ato kanë arritur në 928 milionë euro, krahasuar me 895 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit 2024, që përfaqëson një rritje prej rreth 3.7 për qind. Pjesa dërrmuese e remitencave vazhdon të vijë nga tri destinacionet kryesore të mërgatës kosovare: Gjermania (38.4 %), Zvicra (17.4 %) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (7.4 %), duke ruajtur një strukturë gjeografike të qëndrueshme ndër vite.

Në kuadër të llogarisë financiare, Kosova vazhdoi të tërheqë të Investimeve të Jashtme Direkte (IJD) edhe gjatë vitit 2025 me një vëllim pak a shumë të ngjashëm me vitin paraprak.

Megjithatë, struktura sektoriale e këtyre investimeve mbetet e ngushtë dhe e përqendruar kryesisht në sektorin e patundshmërisë, çka kufizon ndikimin e tyre afatgjatë në rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së ekonomisë. Deri në këtë periudhë të vitit, rreth 78 përqind e IJD-ve janë orientuar në aktivitetet e patundshmërisë. Në aspektin gjeografik, vendet kryesore të origjinës së këtyre investimeve mbeten ato ku është e përqendruar edhe pjesa më e madhe e diasporës kosovare. Gjermania zë 27 për qind të totalit të IJD-ve, e ndjekur nga Zvicra me 24 për qind, Shqipëria me 12 për qind, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës me dhjetë për qind.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse arriti në afër nëntë përqind të PVB-së në vitin 2024, nga 7.6 sa ishte në vitin 2023, duke tejkaluar mesataren rajonale (FMN, 2025; Banka Botërore, 2025b). Të dhënat për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025 tregojnë një thellim të mëtejshëm të këtij deficiti, në 807.6 milionë euro ose 16.8 përqind të PVB-së, nga 15.3 përqind në të njëjtën periudhë të vitit 2024. Bilanci i llogarisë financiare dhe bilanci i pagesave totale tregojnë gjithashtu një përkeqësim, me deficite që arritën përkatësisht në -587.5 milionë euro dhe -792.5 milionë euro në gjashtë muajt e parë të vitit 2025 (Tabela 6).

● **Tabela 6.** Statistikat e sektorit të jashtëm dhe bilancit të pagesave

	Remitencat		Investimet e jashtme direkte		Llogaria rrjedhëse		Bilanci nga llogaria financiare		Bilanci i pagesave	
	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)
2019	851.5	12.1	254.6	3.6	-408.3	-5.8	-161.1	-2.3	-399.5	-5.7
2020	980	14.5	345.7	5.1	-454.7	-6.7	-562.1	-8.3	-472.2	-7.0
2021	1,153.4	14.5	420.7	5.3	-632.5	-7.9	-365.0	-4.6	-694.7	-8.7
2022	1,222.8	13.7	732.0	8.2	-878.7	-9.9	-661.6	-7.4	-917.1	-10.3
2023	1,335.8	13.8	840.1	8.7	-729.4	-7.5	-415.5	-4.3	-666.5	-6.9
2024	1,355	13.4	793.5	7.8	-914.8	-9.0	-639.3	-6.3	-883.2	-8.7
2024 (Jan - Qer)	630.1	13.9	419.1	9.3	-691.8	-15.3	-496.6	-11.0	-667.9	-14.8
2025 (Jan - Qer)	654.7	13.6	431.5	9.0	-807.6	-16.8	-587.5	-12.2	-792.5	-16.5

Burimi: BQK dhe ASK (2025)


Në planin afatshkurtër, rrisqet për sektorin e jashtëm janë të larta. Ngadalësimi i ekonomive kryesore të BE-së, sidomos Gjermanisë, mund të ndikojë në kërkesën për eksportet e Kosovës. Njëkohësisht, tensionet gjeopolitike dhe ndryshimet në politikat tregtare të imponuara nga ekonomitë e mëdha – si SHBA, BE dhe Kina – përmes tarifave mbrojtëse, barrierave jo-tarifore dhe rregulloreve të reja industriale, paraqesin rrezik për zinxhirët globalë të furnizimit dhe për rrjedhën e IJD-ve që vinë drejtpërdrejtë ose tërthorazi përmes partnerëve tregtarë evropianë të Kosovës. Nga ana tjetër, avancimi në proceset integruese në BE mund të mobilizojë më shumë financim të huaj dhe të përshejtojë konkurrueshmërinë e eksporteve. FMN-ja rekomandon politika që rrisin konkurrueshmërinë, diversifikojnë eksportet, ulin varësinë nga diaspora dhe kufizojnë informalitetin (FMN, 2025).

1.5 Sektori financiar

Sektori financiar në Kosovë vazhdon trendin pozitiv të rritjes, performancës dhe stabilitetit. Në strukturën e bankave komerciale operojnë gjithsej 11 banka, prej të cilave 8 janë me kapital të huaj dhe përfaqësojnë 82.6 përqind të asetëve totale. Numri i degëve mbetet i pandryshuar ndërsa numri i të punësuarve ka shënuar rritje të lehtë krahasuar me vitin paraprak. Digjitalizimi i pagesave ka shënuar një trend të rritjes gjatë vitit, ngjashëm me atë të përdorimit të e-bankingut.


Treguesit financiarë konfirmojnë profitabilitet të lartë dhe kapitalizim të mirë: ROA ka qëndruar në 2.5 përqind dhe ROE në 18.4 përqind. Një ROA prej 2.5 përqind tregon se bankat në Kosovë arrijnë të gjenerojnë përfitime mbi mesataren për çdo njësi të asetëve që menaxhojnë. Ndërsa, një ROE prej 18.4 përqind reflekton kthim të lartë mbi kapitalin e investuar, duke bërë që bankat në Kosovë të jenë relativisht tërheqëse për investitorë.

● **Figura 1.** Indikatorët e likuiditetit dhe raporti kredi/depozitë për bankat komerciale, periudha 2019-2025



Burimi: BQK (2025)

● **Figura 2.** Mbitërheqjet dhe linjat kreditore gjatë periudhës 2019-2024 (në milionë euro)



Burimi: BQK (2025)


Raporti kredi/depozitë ka arritur në 88.7 përqind (shih figurën 1), duke u rritur krahasuar me vitin paraprak. Ky zhvillim sinjalizon se kreditimi po zgjerohet në ritme më të shpejta se depozitat. Aktualisht kjo shifër mbetet në nivele të shëndetshme, por nëse vazhdon trendi rritës mund të paraqes rrezik për likuiditetin bankar, duke kufizuar hapësirën për financim të qëndrueshëm afatgjatë, dhe duke rritur barrën e konsumatorëve përmes normave më të larta të interesit. Megjithatë, raporti i likuiditetit mbetet i qëndrueshëm në 29.5 përqind. Edhe pse me një tendencë përkeqësimi por megjithatë ky nivel dëshmon se bankat kanë kapacitet të mjaftueshëm t'i përballojnë detyrimet afatshkurtra.

Kreditë jo-performuese (2 përqind) mbeten në nivel të ulët, mirëpo rritja e mbitërheqeve dhe linjave kreditore, sidomos tek korporatat jo-financiare, tregon rritje të varësisë nga instrumentet afatshkurtra për të menaxhuar nevojat për likuiditet. Vetëm në Gusht të këtij viti, mbitërheqjet e korporatave arritën në 518.9 milionë euro, ndërsa linjat kreditore në 391.1 milionë euro, çka mund të sinjalizojë rritje të stresit financiar dhe mbingarkesë kreditore. Poashtu, edhe ekonomitë familjare kanë përdorur mbitërheqje prej 103.5 milionë euro, duke reflektuar nevojën për financim

të shpejtë për konsum apo shpenzimet të papritura. Siç paraqitet në figurën 2, mbitërheqjet dhe linjat kreditore janë rritur ndjeshëm (më shumë se 50 përqind) krahasuar me periudhën para pandemisë Covid-19.

Kreditimi në sektorët e ekonomisë nga bankat poashtu ka shënuar rritje vjetore prej 19.5 përqind. Rritjen më të lartë të kredive e kanë shënuar ekonomitë familjare me 23 përqind, përderisa rritje të kredive shohim edhe tek korporatat jo-financiare dhe bizneset tjera me 16.4 përqind (shih figurën 3). Kjo rritje e shpejtë ngre shqetësime mbi cilësinë e portofolit të kredive. Të dhënat e muajit Gusht tregojnë ulje të stokut të kredive aktive me rreth 15 milionë euro, një zhvillim i pazakontë pas disa vitesh rritje të vazhdueshme. Për më tepër kjo e shoqëruar me rritje të kredive (dhe mbitërheqeve) për ekonomitë familjare sinjalizon nevojën e rritur të qytetarëve për të përballuar kushtet më të vështira të jetesës si pasojë e inflacionit, pagave të ulëta dhe shkallës së ulët të punësimit. Kjo nënkupton se këto kredi janë kryesisht konsumuese, dhe si të tilla nuk ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit sidomos në kushtet e ofertës vendore të vendore.

● **Figura 3.** Rritja vjetore e kredive dhe depozitave gjatë periudhës 2020-2025 (në %)




Burimi: BQK (2025)

Struktura e kredive sipas sektorëve mbetet e pa përmirësuar duke e dominuar ndjeshëm nga shërbimet që kryesojnë me 64 përqind të vlerës totale, pasuar nga industria, energjetika dhe ndërtimtaria me 34 përqind. Ndërsa, kreditë bujqësore vazhdojnë të përbëjnë një pjesë shumë të vogël të portofolit, vetëm 1.8 përqind të totalit.

Në të njëjtën kohë, edhe depozitat kanë shënuar rritje vjetore prej 13.9 përqind (shih figurën 3), duke reflektuar ritëm më të shpejtë se vitin paraprak. Normat e interesit janë rritur si pasojë e inflacionit dhe kërkesës më të lartë për kredi. Rritje të normave të interesit kemi si në kredi, ashtu edhe në depozita (shih figurën 4), duke rritur kështu marginën e interesit nga 2.8 në 3 pikë përqindje, gjë që rrit përfitimet bankare, por kjo duket se po vështirëson më tutje barrën për huamarrësit.

● **Figura 4.** Normat e interesit të kredive dhe depozitave, periudha 2019-2025, (në %)




Burimi: BQK (2025)

Përpos bankave komerciale, edhe sektorët e tjerë financiarë kanë ndjekur trendin rritës. Kompanitë e sigurimeve kanë shënuar rritje të ndjeshme të fitimit neto, si dhe përmirësim të treguesve të performancës (ROA - 5.4 përqind dhe ROE- 16.9 përqind). Institucionet mikrofinanciare kanë rritur ndjeshëm kreditimin, sidomos për ekonomitë familjare, me një rritje prej 20.6 përqindje krahasuar me vitin paraprak.

Sektori financiar i Kosovës vazhdon poashtu të ketë ekspozim të lartë ndaj sektorit të jashtëm. Asetet e jashtme neto gjatë muajit Gusht kanë arritur në 5.4 miliardë euro, një rritje prej 9 përqind krahasuar me të njejtin muaj të vitit paraprak. Fondi i Kursimeve Pensionale kryeson me 2.8

miliardë euro, pasuar nga Banka Qendrore e Kosovës me 1.6 miliardë euro, dhe bankat komerciale me 1.02 miliardë euro. Kjo strukturë tregon varësi të konsiderueshme nga tregjet e jashtme financiare, gjë që mund të rrisë ndjeshmërinë e kursimeve pensionale (dhe aseteve tjera) ndaj luhatjeve ndërkombëtare. Sa i përket performancës së fondeve pensionale, shohim përmirësim në vlerën e aksionit për Fondin e Kursimeve Pensionale (FKPK), krahasuar me të njejtën periudhë të vitit paraprak (shih figurën 5). Kthimi në investime per FKPK ka shënuar ulje të konsiderueshme, që nënkupton se tregjet financiare nuk kanë qenë të favorshme. Mirëpo vlera e aseteve është rritur dukshëm (për 17.4 përqind).

● **Figura 5.** Indikatorët e performancës së Fondeve Pensionale, analizë krahasuese Janar- Gusht 2024/25, (në %)



Burimi: BQK (2025)

1.6 Shpenzimet qeveritare – Buxheti


1.6.1 Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore

Politika buxhetore e Kosovës për vitin 2025 dhe parashikimet për 2026 konfirmojnë vazhdimësinë e një modelit buxhetor i cili nuk siguron ende transformimin e politikës fiskale drejt rritjes ekonomike cilësore dhe afatgjate. Buxheti në pjesën e të ardhurave ka një varësi relativisht të lartë nga të ardhurat indirekte si TVSH-ja dhe akciza që reflektojnë varësinë e ekonomisë nga importi dhe konsumi, ndërsa në pjesën e shpenzimeve ka një mbingarkesë në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve si dhe një destinim të pamjaftueshëm dhe aq me tepër realizim të dobët të investimeve kapitale. Kjo strukturë joadekuate e kufizon fleksibilitetin fiskal dhe kapacitetin e qeverisë për të stimuluar një rritje produktive ekonomike.

Në periudhën janar–shtator 2025, janë mbledhur **2.47 miliardë euro nga 3.30 miliardë euro** të planifikuara për tërë vitin apo rreth **73 përqind**. Tek shpenzimet intesiteti është më i ultë përkatësisht **2.02 miliardë ose 61 përqind** e bux-

hetit vjetor. Kjo tregon performancë të mirë në mbledhjen e të ardhurave, por ngec dukshëm në pjesën e shpenzimeve sidomos tek investimet kapitale. Për vitin 2026, të ardhurat janë parashikuar **3.63 miliardë euro, me një rritje 10 përqind**, ndërsa shpenzimet në **3.96 miliardë ose poashtu me një rritje 10 përqind** ndaj këtij viti. Hendeku financiar duhet të mbulohet përmes huamarrjes së jashtme dhe emetimit të letrave me vlerë. Deficiti buxhetor i planifikuar prej **-2.7 përqind të PVB-së** ose 330 milion është pak a shumë i ngjashëm me mesataren e vendeve të BP me përjashtim të Malit të Zi **-3.7 përqind** dhe Maqedonia e Veriut **-4.4 përqind**. Megjithatë, ndryshe nga disa vende të rajonit, Kosova ende nuk ka diversifikuar burimet e të ardhurave dhe mbetet e varur nga konsumi dhe importet. Për të siguruar qëndrueshmëri afatmesme, politika fiskale duhet të fokusohet në rritjen e bazës tatimore, përmirësimin e efikasitetit të investimeve publike dhe orientimin e shpenzimeve drejt sektorëve që nxisin produktivitetin e punës (investime në kapitalin njerëzor, kërkime dhe inovacione) Figura më poshtë megjithatë tregon një tendencë për rritje të hendekut midis të ardhurave dhe shpenzimeve qeveritare në periudhën 2024-2026.

● **Figura 6.** Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore (miliarda euro)




Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026

1.6.2 Të ardhurat buxhetore

Mbledhja e TVSH-së brenda vendit ka pësuar rritje nga 478 milionë në 534 milionë euro në vitin 2025, ajo përbën vetëm rreth 14 përqind të të ardhurave totale, e qe sinjalizon se ende industria vendore, shërbimet nuk kontribuojnë në mënyrë proporcionale në ekonomi. Kjo e vendos në disavantazh ekonominë kosovare përballë rreziqeve të çmimeve të

importit dhe varësisë nga konsumi. Tatimet direkte të cilat përfshijnë rreth 18 përqind të të ardhurave totale në 2025 dhe të rriten me rreth 10 % në 2026 krahasuar me vitin 2025. Kjo normë rritjeje tregon gjithashtu që baza tatimore është ende relativisht e vogël dhe tatimet kontribuese janë të ulëta. Sipas raportit të FMN (2025) formalizimi i ekonomisë dhe zgjerimi i bazës tatimore mbeten ndër sfidat kryesore për mobilizimin e të ardhurave.

● **Figura 7.** Struktura e të ardhurave buxhetore



Burimi: Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026; kalkulimet e autorit nga seritë fiskale

● **Tabela 7.** Struktura e shpenzimeve qeveritare si përqindje e totalit

	2022	2023	2024	2025 Parashikim	2026 Parashikim
Paga dhe shtesa	25.7%	26.7%	24.3%	25.4%	24.7%
Subvencione dhe Transfere	41.9%	37.5%	32.1%	32.0%	34.2%
Shpenzimet Kapitale	16.6%	19.5%	25.9%	25.8%	25.2%
Mallra dhe Shërbime	14.3%	14.8%	15.7%	14.9%	13.7%

*për vitet 2022-2024 paraqitet struktura e realizuar, kurse për vitet 2025 – 26 ajo e parashikuar


1.6.3 Struktura e shpenzimeve buxhetore

Kategoria e **pagave** pritet të arrijnë në **980 milionë euro** në 2026 ose 24.7 përqind e buxhetit të përgjithshëm e cila përbrendëson efektet e zbatimit të ligjit të pagave publike dhe premtimin e qeverisë për pagën e 13-të në sektorin publik. Edhe pse ka një rritje të shpenzimeve në këtë kategori disa profesione kyçe si mjekët, profesorët universitar, policët dhe sistemi i drejtësisë mbeten të me paga joadekuate krahas përgjegjësive dhe nevojës. **Subvencionet dhe transferet** pritet të arrijnë në **1.35 miliardë euro** në 2026 ose **34 përqind** të totalit të shpenzimeve. Këto shpenzime janë kryesisht të lidhura me programet sociale, pensionet, por edhe ndryshimet demografike në rritje. Pagesat e njëhershme të qeverisë nga 100 euro për

studentët me një kosto rreth 26 milion euro tregojnë një politikë të orientuar drejt shpenzimeve të njëhershme pa një analizë kritike. Me Subvencionet dhe Transferet (34 %) që tejkalojnë shpenzimet kapitale (25%), politika fiskale e Kosovës anon drejt rishpërndarjes afatshkurtër dhe mbështetjes së kërkesës në vend të shpenzimeve që rrisin produktivitetin dhe konkurrueshmërinë.

Nga ana tjetër, **investimet kapitale** janë planifikuar të jene rreth 1 **miliardë euro** në 2026, me një rritje prej **8.3 përqind krahasuar me vitin paraprak, por ato** mbeten të njëjta në strukturën e përgjithshme të buxhetit dhe jo aderkuate për nevojat zhvillimore dhe potencialin e ekonomisë. Realizimi historikisht i dobët i projekteve kapitale vazhdon të kufizojë efektin e tyre stimulues mbi rritjen ekonomike.

● **Figura 8.** Struktura e shpenzimeve buxhetore



Burimi: MFPT (2025). Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026

● **Tabela 8.** Buxhetimi dhe realizimi i investimeve kapitale (milion euro)

	2021	2022	2023	2024	2025 (Janar - Shtator)
Buxhetimi i Investimeve kapitale	626.1	704.0	819.9	859.2	930.3
Realizimi i Investimeve kapitale	419.7	419.2	554.4	654.6	394.4
Investimet e pa realizuara	206.4	284.8	265.5	204.6	535.9
Përqindja e realizimit	67%	60%	68%	76%	42%

Burimi: Projekt ligjet për ndarjet buxhetore: 2021 – 2025, dhe seritë kohore fiskale të kalkuluara nga autori

Edhe pse buxhetimi i investimeve kapitale ka pësuar rritje graduale nga 704 milionë euro në 2022 në 930 milionë në 2025 normat e realizimit mbeten në nivele relativisht të ulta. Në vitin 2025, deri në shtator janë realizuar vetëm 42 **përqind** e mjeteve të planifikuara për investime kapitale. Edhe këtë vite kemi një ritëm të ngjashëm me vitet e kaluara kur niveli përfundimtar i realizimit rrallë ka tejkaluar 60 **përqind**. Analizat e auditimeve publike theksojnë se pengesat kryesore lidhen me vonesat në procedurat e prokurimit, mospërgatitjen në kohë të projekteve, problemet e shpronësimeve dhe menaxhimin e dobët të kontratave. Si rrjedhojë pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve buxhetore mbetet rreth 25 përqind në nivel planifikimi por të shumtën rreth 20 përqind kur vie puna tek realizimi. Këtu reflektohet edhe një dobësi strukturore në transformimin e buxhetit drejt rritjes produktive. Kjo pjesëmarrje do të duhej të rritej në rreth 30% të buxhetit duke marrë parasysh nivelin e zhvillimit dhe nevojat për një transformim në sektorë ekonomik, e sidomos në shëndetësi dhe arsim, kërkime dhe inovacion.

Analiza e shpenzimeve sektoriale bazohet në Kornizën Afatmesme të Shpenzime (KASH) e cila duhet të miratohet nga Qeveria e Kosovës deri me 15 Qershor të vitit përkatës. Meqenëse këtë vit, KASH nuk është hartuar dhe miratuar nga Qeveria e Kosovës, kjo e vështirëson analizën sektoriale ekonomike dhe orientimet e qeverisë për vitet e ardhshme. Në mungesë të këtij dokumenti kyç, analiza sektoriale bazohet në dokumentin e vitit të kaluar. Struktura e shpenzimeve sektoriale për vitin 2026 tregon një zhvendosje të moderuar me një

theks më të madh në financat publike, energjinë, dhe mjedisin, ndërsa disa sektorë tradicionalë si administrata publike, drejtësia dhe kujdesi social mbeten relativisht në terma të njëjtë. Krahasuar me vitin 2025, sektori i energjisë shënon një rritje të theksuar prej 44 **përqind**, duke arritur 86 milionë euro, të cilat duket se janë në përputhje me angazhimet e qeverisë për tranzicion të gjelbër dhe projekte në eficiencën energjetike. Rritje të dukshme ka edhe sektori i mjedisit me 22.5 përqind, që tregon një vëmendje ndaj politikave mjedisore. Kujdesi social mbetet përsëri sektori më i financuar me 764 milionë euro ose rreth 7 **përqind** të PVB-së dhe afërsisht trefishin e fondeve të ndara për shëndetësi. Sektorët e shëndetësisë dhe arsimit vijojnë me rritje modeste prej 5 **përqind** përkatësisht, duke ruajtur peshën e tyre tradicionale në strukturën buxhetore, por ende dukshëm nën nivelet e vendeve të rajonit. Në shëndetësi në vitin 2024, shpenzimet përbënin vetëm 3.08 përqind të PVB-së dhe 9.8 përqind të shpenzimeve buxhetore, me projeksione për të arritur në 3.4% të PVB-së dhe 10.5% të shpenzimeve buxhetore në vitin 2025. Ky nivel mbetet dukshëm më i ulët se shpenzimi mesatar i ekonomive të BE-së në PVB, që ishte rreth 7.3 përqind (2023), si dhe më poshtë se mesatarja e ekonomive të Ballkanit Perëndimor prej 5.95 përqind. Sa i përket arsimit, shkencës dhe inovacionit, financimi mbetet tejet i ultë në kërkime dhe inovacione (K&I). Sipas Ligjit Kosova duhet të ndajë 0,7 përqind të buxhetit të saj për financimin e sektorit të K&I. Mirëpo deri më tash mjetet e ndara për financimin e K&I kanë qenë rreth 1 deri 1,5 milionë euro në vjet, që paraqesin rreth 0,1 përqind të buxhetit të Kosovës.

● **Tabela 9.** Korniza e shpenzimeve sektoriale në nivel qendror (milion euro)

Sektorët	2024 (Realizuar)	2025 (Buxhetuar)	2026 (Buxhetuar)	Përqindja e rritjes ose zvogëlimit (2026/2025)
Administrata publike	123.3	123.3	108.6	-11.9%
Financat publike	200.3	178.6	301.9	69.0%
Politika e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare	47.5	48.1	50.8	5.5%
Mbrojtja dhe Siguria	153.0	158.7	163.3	2.9%
Siguria Publike	185.1	204.2	213.7	4.7%
Drejtësia	101.4	111.8	103.1	-7.8%
Mjedisi	72.9	60.7	74.4	22.5%
Transporti dhe Komunikacioni	205.0	272.8	275.0	0.8%
Energjia	59.5	59.6	86.0	44.3%
Mbështetja Për Biznese Dhe Industri	31.3	39.7	41.0	3.3%
Bujqësia	89.8	90.3	95.3	5.5%
Kultura, Rekreacioni Dhe Sporti	99.2	107.0	107.3	0.3%
Tregu i Punës Dhe Punësimi	33.5	33.8	34.0	0.5%
Kujdesi Social	713.2	770.7	764.2	-0.8%
Shëndeti	263.7	275.0	288.8	5.0%
Arsimi Dhe Shkenca	134.4	139.3	146.1	4.9%


Burimi: Korniza Afatmesme e shpenzimeve 2025 -2027

1.6.4 Analiza e borxhit shtetëror

Borxhi publik i Kosovës ende mbetet në nivele të qëndrueshme dhe nën kufirin ligjor prej 40 përqind të PVB-së, megjithëse shënon një rritje graduale gjatë dy viteve të fundit. Në vitin 2026, borxhi i përgjithshëm pritet të arrijë në 2.75 miliardë euro, ose 23.8 përqind të PVB-së, nga 21.4 përqind një vit më parë. Borxhi i brendshëm është rritur në 1.27 miliardë euro, duke përbërë rreth 46 % të totalit. Ai përbëhet kryesisht nga bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare, të cilat përdoren kryesisht për mbulimin e deficitit buxhetor dhe financimin e shpenzimeve rrjedhëse. Ky orientim drejt konsumit, më shumë se drejt in-

vestimeve, tregon kufizimet dhe kapacitetet e institucioneve për të gjeneruar rritje produktive. Ndërkohë, borxhi i jashtëm pritet të shënojë rritje nga 1.21 miliardë euro në 2025 në 1.48 miliardë euro në 2026, duke përfaqësuar tashmë më shumë se gjysmën e totalit të borxhit. Ky borxh dominohet nga kreditë e institucioneve ndërkombëtare, Banka Botërore, BE, FMN dhe BERZH – të destinuara për projekte në energji, transport, mjedis dhe reformën e financave publike. Megjithëse struktura e borxhit të Kosovës mbetet e shëndetshme dhe brenda standardeve, sfida kryesore mbetet përdorimi i joefektiv i fondeve të huamarrjes dhe vonesat e mëdha në realizmin e projekteve të financuara nga huat.

● Figura 9. Struktura e borxhit shtetëror të Kosovës



Burimi: Programi i borxhit publik 2025 – 2027

MJEDISI BIZNESOR

2

Ky kapitull paraqet një përmbledhje zhvillimet në mjedisin biznesor në Kosovë gjatë tre viteve të fundit, duke u përqendruar në barrierat strukturore dhe institucionale që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorit privat. Sfidat që ndërlikohen me kuadrin ligjor e rregullativ, qasjen në financa, niveli i informalitetit, tregu i punës, infrastruktura dhe barrierat e brendshme të bizneseve vazhdojnë të ndikojnë në klimën e investimeve dhe konkurrueshmëri. Këto gjetje konfirmojnë edhe me vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare si OECD (2024), dhe Banka Botërore (2025) të cilat theksojnë se ekonomia e Kosovës po përballlet me sfida strukturore që kërkojnë reforma të vazhdueshme në qeverisje, sundim të ligjit dhe rritje të produktivitetit.

Gjatë vitit 2025 ka një rritje prej rreth 9 përqind të bizneseve të reja dhe atë kryesisht në tregti, ndërtimtari, prodhim dhe shërbime profesionale. Nga 12,051 biznese të reja të regjistruara, 99.2 përqind ishin me 1–9 punonjës, e që përputhet me strukturën e përgjithshme të ndërmarrjeve në Kosovë, të dominuar nga bizneset mikro. Nga ana tjetër, gjatë vitit 2025 u mbyllën 1,637 biznese, e dhënë që reflekton sfidat e vazhdueshme në mjedisin e biznesit, por që mbetet në nivel të menaxhueshëm krahasuar me trendet afatgjata të raportuara nga ASK (2025).

2.1 Barrierat kryesore në mjedisin biznesor 2025

Në vijim janë të përmbledhura rezultatet nga anketat e rregullta të Institutit Riinvest për një serë indikatorësh dhe pengesash me të cilat ballafaqohen bizneset në Kosovë. Tabela e barrierave pasqyron rreth 22 indikatorë të perceptuar nga bizneset në periudhën 2017–2025. Për vitin 2025, vërehet një lëvizje e rëndësishme në strukturën e barrierave në krahasim me vitin 2024. Nga të dhënat e anketës me udhëheqës të bizneseve shohim se barrierat më të theksuara lidhen me (i) Migrimi i punëtorëve (ii) Kostoja e lartë e financimit, (iii) Normat tatimore, (iv) Aftësitë dhe arsimimi i punëtorëve, (v) Evazioni fiskal dhe informaliteti dhe (vi) Furnizimi me energji elektrike.

Migrimi i punëtorëve megjithëse ka një rënie të lehtë mbetet barriera më e theksuar edhe për vitin 2025. Për më tepër edhe raportet e OECD dhe Banka Botërore theksojnë se rënia e popullsisë në moshë pune dhe emigrimi i

të rinjve të kualifikuar po kthehet në një nga sfidat më të rëndësishme të produktivitetit dhe konkurrueshmërisë në Kosovë. **Kostoja e financimit**, edhe pse ka rënë lehtë në intensitet, vazhdon të mbetet sfida kryesore e bizneseve në vitet e fundit. Kjo rënie mund të lidhet me zgjerimin e garancive kreditore të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) por normat e larta të interesit vazhdojnë të kufizojnë investimet, veçanërisht në sektorët prodhues. **Aftësitë dhe arsimimi** i punëtorëve gjithashtu mbetet një pengesë serioze për bizneset edhe pse duket se ka një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2024. Kjo mund të shpjegohet me rritjen e investimeve në trajnime nga ana e bizneseve por edhe përmirësimet sa i përket një përgjegjëse më të mirë ndaj nevojave të tregut të punës me ofertën e shkollave profesionale dhe me implementimin e skemës së arsimit dual. Megjithatë, studimet e ASHAK (2021) dhe Riinvest (2024b) tregojnë se mospërputhja e aftësive të punëtorëve me tregun e punës mbetet strukturore dhe do kohë për t'u përmisuar. **Furnizimi me energji elektrike**, që në 2024 ishte barriera me intensitet të ulët (39.3), është rritur ndjeshëm më 2025 (49.8). Kjo kryesisht shpjegohet me pasigurinë në importet të energjisë, daljen në treg të hapur të energjisë për bizneset e mëdha dhe rritjen e çmimit që ndikon në rritjen e kostove si dhe mungesën e kapaciteteve të reja në prodhim, çështje këto që evidentohen edhe në Raportin e Komisionit Evropian (2025) për Kosovën.

● **Tabela 10.** Barrierat në mjedisin biznesor

Viti	2017	2023	2024	2025
Migrimi i punëtorëve	-	75.2	64	54.8
Shpenzimet e larta të financimit (norma të larta të interesit)	56.5	63.5	56.8	53.0
Normat Tatimore	57.3	63.7	51.7	52.9
Aftësitë dhe arsimimi i punëtorëve	38.7	55.1	60.4	52.2
Evazioni fiskal dhe informaliteti	57	63.5	64.7	51.6
Administrata tatimore joefikase	53.8	62.8	52.4	51.1
Furnizimi me energji elektrike	51.2	57.2	39.3	49.8
Shkelja e kontratave nga konsumatorët dhe furnizuesit	-	-	48	49.0
Siguria dhe stabiliteti politik	52.2	57.6	44.1	47.0
Qasja në kredi	50.7	58	51.4	46.1
Ndryshimet e shpejta teknologjike	-	-	42.1	45.7
Qasja në informacione për ndërmarrjen	37.1	55.3	39.7	44.9
Procedurat e licensimit	43.8	-	39.9	44.4
Standardet e prodhimit	-	-	42.6	44.1
Qasja në lokacion (tokë) për biznes	-	-	44.4	43.9
Ligjet dhe sistemi gjyqësor	52.8	55.4	47.3	43.4
Korrupsioni	58.9	59.8	59.4	43.2
Ligji dhe rregulloret e punës	-	-	38.4	43.1
Doganat	47	60.6	47.4	43.0
Barrierat jo tarifore	-	-	43.6	43.0
Transporti	35.7	51.2	35.8	41.4
Telekomunikimi	32	47.6	31	39.6

Burimi: Riinvest (2025)

2.2 Rregullativa ligjore dhe fiskale

Barriera të tilla si administrata tatimore joefikase dhe funksionimi i sistemit gjyqësor renditen në segmentin e barrierave me intensitet mesatar, megjithatë norma tatimore mbeten ndër tre barrierat kryesore. Edhe pse në shikim të parë normat tatimore në Kosovë janë të ulta, sipas OECD (2024), struktura tatimore në Kosovë është e thjeshtë, por jo mjaftueshëm stimuluese për investime afatgjata, sidomos për bizneset prodhuese. Sa i përket Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) ndryshimi në perceptimin e bizneseve ndërlidhet me ngritjen e efikasitetit dhe performancës, progresin në digjitalizimin e shërbimeve dhe implementimin e ligjit të ri për Administratën Tatimore, një zhvillim që theksohet edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian (2024). Sistemi gjyqësor mbetet barrierë e rëndësishme. Banka Botërore dhe Komisioni Evropian nënvizojnë se vonesat në zgjidhjen e kontesteve biznesore për shkak të mungesës së kapaciteteve gjyqësore që ndikon tek rritja e pasigurisë ligjore për investitorët. Reformat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për zvogëlimin e barrës administrative (2020–2027), përfshirë thjeshtimin e mbi 150 shërbimeve administrative dhe përparimet në digjitalizim edhe pse të ealzuara jo plotësisht kanë pasur ndikim pozitiv në perceptimin e bizneseve. Megjithatë, OECD rekomandon forcimin e mekanizmave të zbatimit për të garantuar stabilitet rregullator dhe transparencë më të madhe.

2.3 Qasja në financa

Për vitin 2025, në aspektin e financimit të bizneseve, qasja në kredi dhe kostoja e financimit mbeten ndër barrierat më serioze ekonomike. Ndërsa qasja në kredi ka shënuar përmirësim të lehtë, sfida të tjera gjithashtu mbeten të pranishme. Këtë viti kemi një rritje të normave të interesit nga bankat komerciale sidomos për bizneset prodhuese. Sipas OECD (2024), Kosova ka nivelin më të ulët të financimeve alternative në rajon, me mungesë të kapitalit sipërmarrës, fondeve të inovacionit dhe rrjeteve të investitorëve engjëj. Nga ana tjetër Banka Botërore tregon se kërkesat e larta për kolateral, struktura e ngushtë e tregut bankar dhe informatizimi i kufizuar i historikut kreditues vazhdojnë të ndikojnë në investimet private. Ndryshim pozitive mbetet roli në rritje i Fondit Kosovar për Garanci të Kredive, i cili gjatë viteve

të fundit ka lehtësuar dukshëm stimulimin e kreditimit për NVM-të. Zgjerimi i dritareve të reja të garancive dhe orientimi i tyre në sektorë prodhues dhe eksportues përputhet edhe me rekomandimet e Riinvest (2024) për orientim të politikave drejt rritjes së produktivitetit dhe mënyrave të financimit. FKGK mund të garantojë deri në 80% të portofoleve të kredive të institucioneve financiare për NMV-të në fusha të tilla si efikasiteti i energjisë dhe bujqësia e qëndrueshme. Deri më tani, FKGK ka lëshuar 799 milionë euro në kredi të garantuara (Komisioni Evropian, 2025).

2.4 Ekonomia informale dhe korrupsioni

Reduktimi i ekonomisë informale në Kosovë mbetet një sfida e madhe socio-ekonomike pavarësisht përpjekjeve të bëra vitet e fundit nga institucionet qeveritare. Kosova karakterizohet nga nivele relativisht të larta të evazionit fiskal dhe punës së padeklaruar, të cilat dobësojnë aftësinë e qeverisë për t'u ofruar të mira publike qytetarëve të saj dhe krijojnë një mjedis të pafavorshëm biznesi përmes konkurrencës së padrejtë. Edhe pse për vitin 2025 informaliteti ka regjistruar një rënie të lehtë në intensitet ende mbetet një nga sfidat më strukturore të ekonomisë së Kosovës. OECD (2024) thekson se pesha e lartë e ekonomisë informale dëmton konkurrencën e ndershme dhe ul të hyrat fiskale. Bizneset e vogla dhe mikro janë më të ekspozuara ndaj presionit konkurrues nga subjektet informale, veçanërisht në tregti dhe shërbime. Sipas FMN-së (2022) fakotrët kryesor që nxisin informalitetin janë; mungesa e besimit në institucionet zyrtare, korrupsioni, administrimi joefikas i drejtësisë dhe zbatimi i dobët i masave ligjore. Instituti Riinvest në vazhdimësi përcjell nivelin e informalitetit në Kosovë përmes anektitimit të bizneseve që rezultojnë të jetë diku mes 30 – 35 përqind e PVB.

Niveli i korrupsionit mbetet një problem i real në Kosovë duke penguar zhvillimet në forcimin e sundimit të ligjit dhe përmirësimin e klimës së biznesit të vendit dhe atraktivitetin e investimeve. Riinvest (2024c). Pavarësisht perceptimit më të mire për vitin 2025, raportet ndërkombëtare të OECD, theksojnë se progresi në luftën kundër korrupsionit është i kufizuar dhe mungojnë rezultate të matshme në çështjet e profilin të lartë. Sektori privat vazhdon të ndeshet me sfida në prokurim publik, zbatim të kontratave dhe transparencë in-

stitucionale. Sipas raportit të progresit të Komisionit Europian (2025) thuhet se Kosova është midis një faze të hershme përgatitjeje dhe një niveli të caktuar përgatitjeje në luftimin e korrupsionit dhe ka bërë përparim të kufizuar. Kosova ka bërë një përmirësim të mëtijshëm në gjykimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, gjë që rezultoi në një numër më të madh vendimesh dhe dënimesh gjyqësore përfundimtare, për dënim nga zvogëlimi i numrit të përgjithshëm i hetimeve dhe dënimeve përfundimtare në rastet e korrupsionit jo të nivelit të lartë. Kosova ende nuk ka një kornizë strategjike valime në vend në fushën e luftës kundër korrupsionit

2.5 Tregu i punës

Edhe në vitin 2025, tregu i punës vazhdon të jetë një ndër faktorët më përcaktues për mjedisin e biznesit. OECD dhe Banka Botërore evidentojnë tre sfida strukturore; (i) migrimi i lartë i fuqisë punëtore, sidomos i punëtorëve të kualifikuar, (ii) pjesëmarrja e ulët në tregun e punës, sidomos e grave (iii) mospërputhja e aftësive dhe kërkesave të tregut. Migrimi vazhdon të dëmtojë rëndë kapacitetin e bizneseve për të mbajtur dhe rekrutuar punëtorë të rinjë. Studimet e Riinvest (2024) tregojnë se kompanitë po reagojnë duke rritur pagat, duke investuar në kushte më të mira pune dhe duke orientuar investime në teknologji, megjithatë mungesa e kapitalit njerëzor të kualifikuar mbetet pengesë madhore. Një tjetër aspekt i rëndësishëm janë edhe aftësitë dhe arsimimi i punëtorëve që vazhdojnë të jenë ndër barrierat kryesore (52.2 pikë). Studimet e Institutit Riinvest (2023) dokumentojnë qartë hendekun e madh në formimin profesional, mungesën e programeve të praktikës dhe koordinimin modest midis biznesit dhe arsimit profesional. Raportet e Bankës Botërore (2025b) theksojnë se kapitali njerëzor mbetet i jomjaftueshëm i përdorur me pjesëmarrje të ulët në fuqinë punëtore dhe punësim, duke kufizuar potencialin e rritjes ekonomike t. Rënia e lindshmërisë dhe migrimi i vazhdueshëm jashtë vendit paraqesin presione të mëtijshme në tregun e punës gjithashtu ato theksojnë nevojën për të përmirësuar cilësinë e arsimit profesional dhe mundësitë e trajnimit brenda punës.

2.6 Barrierat administrative dhe infrastruktura

Në vitin 2025 vërehet një stabilizim i perceptimeve për barrierat infrastrukturore dhe administrative, megjithëse ato mbeten ende sfida të rëndësishme. Furnizimi me energji ka shënuar rritje të ndjeshme të intensitetit (49.8 pikë), duke reflektuar pasiguritë në tregjet energjetike dhe varësinë nga importet. Procedurat e licencimit kanë shënuar rritje në intensitet (44.4 pikë), gjë që mund të lidhet me kompleksitetin e rregullimeve sektorale në disa industri, veçanërisht në prodhim dhe ushqim.

2.7 Barrierat e brendshme

Barrierat e brendshme tek biznesi vazhdojnë të ndikojnë negativisht në aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve në Kosovë. Ndryshimet e shpejta teknologjike, edhe pse vlerësohen me intensitet të ulët (45.7 pikë), tregojnë se bizneset ende nuk investojnë mjaftueshëm në inovacion dhe transformim digjital. OECD (2024) vlerëson se niveli i investimeve në teknologji mbetet nën mesataren e rajonit. Qasja në informacion dhe standardet e prodhimit mbeten sfida mesatare. Siç thekson edhe Riinvest (2024) mungesa e trupave certifikues dhe laboratorëve të akredituar përbën pengesë për ndërmarrjet që synojnë eksportet. Angazhimi i institucioneve për të zhvilluar kapacitetet laboratorike dhe certifikuese është një hap pozitiv, por ndikimet e këtyre reformave do të materializohen vetëm në periudhë afatmesme.

2.8 Liberalizimi i tregut të energjisë dhe mjedisi biznesor në Kosovë

Liberalizimi i çmimeve të energjisë elektrike për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, shënoi një etapë të rëndësishme në përafrimin e Kosovës me Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe në përpjekje për krijimin e një tregu më funksional dhe konkurrues. Me këtë ndryshim, vendi filloi të largohet nga modeli shumëvjeçar i tarifave të rregulluara, të cilat kishin mbajtur çmimet nën nivelin real të tregut për më shumë se një dekadë. Vetëm gjatë periudhës 2018–2023, ky model kri-

joi rreth 2.2 miliardë euro subvencione të nënkuptuara¹³, nga të cilat afërsisht 2 miliardë euro u gjeneruan gjatë krizës energjetike 2021–2023. Për të mbështetur këtë skemë, qeveria dha gjithashtu 608 milionë euro subvencione direkte, prej të cilave 246 milionë euro vetëm në vitin 2022, që përfaqësonin 2.8 përqind të PVB-së (OECD, 2025). Këta tregues e bëjnë të qartë se ky model është i paqëndrueshëm në aspektin fiskal si dhe rritë varësinë nga importet dhe mekanizmat e subvencionimit dhe dekurajon investimet në burime të rinovueshme të energjisë.

Në këtë kontekst, dhe duke pasur parasysh zotimet e Kosovës në kuadër të Komunitetit të Energjisë, kalimi drejt liberalizimit u bë një hap i nevojshëm në reformimin e tregut. Më 1 qershor 2025, të gjitha ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, me mbi 10 milionë euro qarkullim vjetor ose më shumë se 50 të punësuar, u detyruan të dalin nga Furnizimi me Shërbim Universal (FSHU) dhe të blejnë energjinë nga tregu i hapur. Në këtë kategori janë përfshirë rreth 1,200 kompani, që përfaqësonin afërsisht 10% të konsumit të energjisë.

Ky tranzicion i zhvendosi bizneset nga një regjim çmimesh relativisht të ulëta dhe të parashikueshme, në një mjedis ku çmimet pasqyrojnë kushtet e tregut, përfshirë kufizimet reale në lidhje me nivelin konkurrencës dhe ofertës së furnizuesve. Pas hyrjes në tregun e hapur, ndërmarrjet raportuan se ofertat për furnizim për vitin 2025 në mesatare u ofruan me rreth 0.19€/kWh, që ishte më shumë se dyfishi i tarifave mesatare të rregulluara të vitit 2024.¹⁴ Sipas të dhënave të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE, 2025), çmimi mesatar për konsumatorët jo-familjar në vitin 2024 kishte qenë 0.93 €/kWh. Ky ndryshim i menjëhershëm i çmimeve krijoi presione të ndjeshme mbi bizneset, veçanërisht ato prodhuese, të cilat u përballën me rritje të konsiderueshme të kostove të funksionimit.

Megjithatë, analizat e German Economic Team (GET, 2025a) sugjerojnë se ky nivel i lartë i çmimeve pritet të stabilizohet rreth 120 €/MWh në periudhë afatmesme, teksa konkurrenca në treg e furnizuesve rritet. Edhe pse ky çmim është më i ulët se ofertat fillestare të marra nga bizneset, prapë se

prapë, i njëjti mbetet përsëri rreth 30 përqind më i lartë se tarifat e rregulluara nga viti i kaluar, duke sinjalizuar një rritje strukturore të kostove të energjisë për bizneset.

Ky ndryshim i madh në kostot e energjisë ka pasur pasoja të ndryshme nëpër sektorë të ndryshëm. Analiza e GET (2025a) tregoi se barra relative e kostove shitesë të energjisë, e shprehur si përqindje e vlerës së shtuar bruto, ishte më e larta në sektorët që shpenzojnë më shumë energji. Industria ushqimore ishte ndër më të ekspozuarat, ku barra relative e kostove shitesë të energjisë arriti deri në 3.8 përqind të vlerës së shtuar bruto të këtij sektori. Sektorë si prodhimi i makinerive, mineralet jo-metalike dhe metaleve pësuan barrë të ngjashme, duke sinjalizuar se kostot e energjisë mund të ndikojnë drejtpërdrejt në konkurrueshmërinë e tyre. Në anën tjetër, sektorët si shërbimet dhe bujqësia, të cilët kanë intensitet më të ulët energjetik, u prekën në masa shumë më të vogla.

Këto pasoja e bëhen edhe më domethënëse kur kombinohen me gjetjet e anketës së Institutit Riinvest (2025), sipas së cilës bizneset që kaluan në tregun e hapur përjetuan një rritje të menjëhershme prej rreth 28 përqind të kostove totale të inputeve. Kjo rritje ndodhi menjëherë pas liberalizimit të çmimeve, në një periudhë kur ndërmarrjet po merrnin oferta shumë të larta për furnizim si pasojë e një tregu të furnizuesve ende joefikas dhe të pazhvilluar. Edhe pse, siç u përmend më herët, pritet që çmimet të bien me rritjen e konkurrencës në treg, kjo megjithatë përfaqëson një rritje të konsiderueshme strukturore të kostove të inputeve për shumë ndërmarrje. Kjo rritje nuk përfshinte vetëm energjinë elektrike, por edhe lëndën e parë dhe shpenzimet e tjera të prodhimit. Meqenëse këto inpute janë pjesë e kostove të ndërmjetme, që zbriten para llogaritjes së vlerës së shtuar bruto, kjo rritje e gjerë e çmimeve tregon se bizneset u përballën me një goditje të dyfishtë: nga njëra anë, rritjen direkte të çmimit të energjisë, dhe nga ana tjetër, rritjen e çmimeve të inputeve që vetë përfshinin kosto të larta energjie në procesin e tyre të prodhimit.

13 Subvencionet e nënkuptuara (ang. implicit subsidies) paraqesin diferencën midis çmimit të rregulluar që paguajnë konsumatorët dhe kostos reale të energjisë në treg ose kostos reale të prodhimit. Kur çmimi i vendosur nga rregullatori qëndron nën këtë nivel real për një periudhë të gjatë, diferenca financohet në mënyrë të tërthortë nga publiku, përmes mjeteve buxhetore, borxhit të kompanive publike ose shtyrjes së investimeve në sistem.

14 Janë evidentuar raste kur këto Oferta kanë qenë edhe më të larta se trefishi i çmimeve mesatare të rregulluara të vitit paraprak.

Kjo e vendosi në pozitë veçanërisht të vështirë industrinë përpunuese. Sektori ushqimor, i cili tashmë funksionon me marzhe relativisht të ulëta, u përball me ngushtim të normeve të fitimit, duke rrezikuar uljen e prodhimit dhe investimeve. Në shumë raste, rritja e kostove të prodhimit nuk mund të transferohet plotësisht tek çmimet e produkteve përfundimtare, duke rënduar më tej gjendjen financiare të tyre.

Rritja e kostove të energjisë krijoi presione të menjëhershme mbi konkurrueshmërinë, veçanërisht në sektorët eksportues. Sipas anketës së Institutit Riinvest, rreth 65 përqind e ndërmarrjeve vlerësuan se tregu i hapur do të ndikonte negativisht në aftësinë e tyre për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare. Kjo reflektonte frikën se rritja e kostove të energjisë do të ngushtonte normat e fitimit dhe do të kufizonte konkurrueshmërinë e produkteve në eksport.

Megjithatë, liberalizimi krijoi edhe nxitje të forta për diversifikim dhe investime në burime të reja të energjisë. Si reagim ndaj këtyre sfidave, një pjesë e bizneseve nisi të ndërmarrë hapa për të reduktuar varësinë nga energjia e blerë në treg. Rreth 22% e ndërmarrjeve deklaruan se kishin zbatuar masa për efizienz të energjisë dhe mbi 12 përqind kanë filluar të përdorin burime të rinovueshme të energjisë. Kjo tregon një orientim në rritje drejt kursimit të energjisë dhe optimizimit të proceseve të prodhimit. Sipas GET (2025b), për shumicën e ndërmarrjeve, kombinimi i kontratave me furnizues privatë dhe instalimi i paneleve solare në objektet e tyre duket të jetë opsioni më i mirë për uljen e kostove. Kjo mund të neutralizonte një pjesë të konsiderueshme të rritjes së çmimeve të tregut, duke ofruar më shumë stabilitet dhe ulje të varësisë nga luhatjet e çmimeve.

Në retrospektivë, vendimi për ta hapur tregun duhej të shoqërohej me një periudhë tranzicioni, të paktën gjashtë muajore, e cila do të kishte lejuar jo vetëm që tregu i furnizuesve të bëhej më konkurrues dhe më efikas, por edhe që ndërmarrjet të kishin kohë të mjaftueshme për të investuar në burime të rinovueshme dhe masa të eficiencës së energjisë. Një fazë e tillë do të kishte ndihmuar në zbutjen e goditjes fillestare nga rritja e çmimeve dhe në reduktimin e pasigurive për sektorin privat.

Megjithëse liberalizimi ishte i vonuar prej kohësh, mungesa e një përkushtimi kredibil nga rregullatori gjatë viteve të kaluara nuk dërgoi sinjalet e duhura për bizneset që të përgatiteshin dhe të nisnin investimet e nevojshme. Rreth vet procesit të aprovimit të liberalizmit të tregut të energjisë u krijua një konflikt midis komunitetit të bizneseve rregullatorit e institucioneve qeveritare që do të mund të shmangej me një objektivitet dhe mirëkuptim në trajtimin e kushteve të liberalizimit, sidomos nivelin e konkurrencës në treg. Pasi rregullatori ka dërguar sinjalet e duhura dhe të kishte dëshmuar kredibilitet në zbatimin e këtij procesi, një periudhë shtesë prej gjashtë muajsh do të kishte qenë e mjaftueshme për një tranzicion më të qetë dhe më të parashikueshëm dhe për sigurimin e një niveli të domosdoshëm konkurrence në tregun e ofertuesve për furnizim. Edhe më tutje mbeten të nevojshme masat mbështetëse për uljen e barrës së bizneseve dhe veçanërisht të atyre sektorëve që rrezikojnë të humbin konkurrueshmërinë si pasojë e kostove të larta të energjisë. Këto masa duhet gjithashtu të nxisin r diversifikimin e burimeve të energjisë nëpërmjet burimve ripërtëritës dhe investimeve në teknologji të pastra, në mënyrë që ky tranzicion në tregun e liberalizuar të jetë më i drejtë dhe më i qëndrueshëm dhe edhe në frymen e tranzicionit të gjelber.

EKSPORTET

3

EKSPORTET

Dinamika e eksporteve: struktura sektoriale, orientimi gjeografik, sfidat dhe implikimet në bilancin tregtar

Në vitin 2024 Kosova shënoi rritje të eksporteve të mallrave me 9.5 për qind krahasuar me një vit më parë (Banka Botërore, 2025b). Ky zhvillim pozitiv dëshmon për rritjen graduale të kapaciteteve prodhuese dhe përpjekjet për të depërtuar në tregje të reja, por të dhënat për nëntë muajt e sivjetmë paraqiten në trend rënieje dhe një trend përkeqësimi të raportit midis importit dhe eksportit duke mbajtur bilancin tregtar nën presion të vazhdueshme (shih seksionin 1.3). Problemi tjetër qenësor është se eksportet mbeten ende të dominuar nga mallrat pa ndonjë vlerë të madhe të shtuar dhe kryesisht në tregje rajonale e evropiane. Importet e mallrave u rritën më shpejtë, të nxitura nga konsumi privat i lartë dhe varësia e vazhdueshme nga ushqimet dhe produktet konsumuese. Kjo ndikoi zgjerimin e deficitit tregtar me 1.1 pikë përqindjeje të PVB-së dhe duke e çuar atë në 27.5 për qind të PVB-së në vitin 2024 (Banka Botërore, 2025b).

Nga këndvështrimi gjeografik, Ballkani Perëndimor mbetet partneri kryesor tregtar i Kosovës, ku eksportohen rreth 45 për qind të totalit të eksporteve, me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut si destinacionet më të rëndësishme. Ndërsa vendet e Bashkimit Evropian përbëjnë afërsisht 35 për qind të eksporteve, me Gjermaninë që mban rolin e tregut më të madh për produktet kosovare. Ky orientim tregon një lidhje të fortë me tregjet evropiane, por njëkohësisht nënvizon nevojën për diversifikim të destinacioneve tregtare dhe përfshirje më të madhe në zinxhirët rajonale të vlerës.

Në anën tjetër, importet e mallrave në vitin 2025 kanë ruajtur një strukturë të ngjashme me vitet e kaluara, duke reflektuar varësinë e lartë të ekonomisë nga furnizimet e jashtme. Rreth 43 për qind e mallrave të importuara vijnë nga vendet e Bashkimit Evropian, 14 për qind nga vendet e rajonit, dhe nga 13 për qind për secilën prej Turqisë dhe Kinës. Brenda kategorisë së vendeve të rajonit vërehet një zhvendosje domethënëse: edhe pse pas marrëveshjes së ratifikuar në vitin 2022 ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, e cila parashton përdorimin e masës së deklarimit të thjeshtuar për

rreth 70 për qind të produkteve të importuara, importet nga Shqipëria fillimisht shënuan rritje gjatë viteve 2023 dhe 2024, të dhënat e tetëmujorit të parë të vitit 2025 tregojnë një rënie të lehtë të importeve nga ky vend krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në të kundërt, importet nga Serbia, të cilat kishin rënë në vitet paraprake, janë rritur sërish në tetë muajt e parë të këtij viti.


Struktura sektoriale e importeve në vitin 2025 tregon disa zhvillime të reja krahas stabilitetit të disa kategorive tradicionale. Ashtu si në vitet e kaluara, produktet minerale – kryesisht lëndët djegëse dhe vajrat minerale – mbeten kategoria më e madhe e importeve me rreth 15 për qind të totalit, duke reflektuar varësinë e ekonomisë nga importi i energjisë. Një zhvillim i ri është futja e mjeteve të transportit në top tre kategoritë e mallrave të importuara me rreth 12 për qind të totalit, duke zëvendësuar disa kategori më të zakonshme në strukturën e mëparshme. Rritja e ndjeshme e importeve të veturave nga Koreja e Jugut përbën një faktor kryesor në këtë ndryshim. Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, vlera e importit të veturave nga ky vend është rritur nga mbi 9 milionë euro në vitin 2023 në 69 milionë euro në vitin 2024 – një rritje pothuajse shtatëfish brenda një periudhe shumë të shkurtër. Në përgjithësi, struktura e tregtisë së jashtme në vitin 2025 mbetet e karakterizuar nga një deficit i lartë tregtar dhe një varësi nga importet e mallrave me vlerë të lartë, ndërkohë që eksportet, megjithëse po rriten në disa sektorë, ende nuk kanë arritur të hapin një proces balancimi me peshën e importeve. Kjo situatë thekson nevojën për politikë të koordinuara që mbështesin rritjen e prodhimit vendor, përmirësimin e konkurrencës së eksporteve dhe zgjerimin e bazës prodhuese drejt sektorëve me vlerë të shtuar më të madhe.

3.1 Diversifikimi i eksporteve

Në vitin 2025, struktura sektoriale e eksporteve të Kosovës mbeti në thelb e pandryshuar krahasuar me vitet paraprake. Metalet bazë dhe artikujt prej tyre vazhdojnë të përbëjnë kategorinë më të rëndësishme të eksporteve, me rreth 24 për qind të totalit, të nxitur nga kërkesa e shtuar për metale në tregjet ndërkombëtare. Në vendin e dytë renditen produktet nga plastika, goma dhe artikujt prej tyre me 14 për qind, ndërsa në vendin e tretë pozicionohen ushqimet, pijet, pijet alkoolike dhe duhani me rreth 12 për qind të totalit të eksporteve. Struktura e tillë, edhe pse tregon disa shenja të diversifikimit në sektorët përpunues, mbetet e dominuar

nga mallra me vlerë të ulët të shtuar dhe e ndjeshme ndaj luhatjeve të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Kjo e bën ekonominë kosovare të ekspozuar ndaj rreziqeve të jashtme dhe thekson nevojën për politika që nxisin zgjerimin e bazës eksportuese drejt produkteve industriale dhe teknologjike. Duke përdorur të dhënat administrative për vitin 2024 (një vit i plotë kalendarik), shohim se struktura e eksporteve të Kosovës mbetet kryesisht e përqendruar në produkte të ndërmjetme – pra mallra që përpunohen minimalisht një herë para se të arrijnë te konsumatori final (figura 10). Kjo strukturë ka implikime të rëndësishme për pozicionimin e vendit në zinxhirët globalë të vlerës.

● **Figura 10.** Struktura e eksporteve sipas distancës me konsumatorin final



■ Përqindja në vlerë totale të eksportit (produktet në nivel 6-shifror sipas nomenklaturës HS)

■ Përqindja e numrit të produkteve të eksportuara (produktet në nivel 6-shifror sipas nomenklaturës HS)

Burimi: Kalkulimet e autorëve nga të dhënat e Doganave të Kosovës

Pesha e lartë e produkteve të ndërmjetme sugjeron se eksportet kosovare janë të ankoruara në segmente të mesme të procesit të prodhimit, ku profitabiliteti por dhe rritja e produktivitetit zakonisht varen nga aftësia për përmirësim të proceseve, certifikimeve dhe stabilitetit të furnizimit. Kjo strukturë pasqyron faktin se ekonomia nuk është as në fazën bazike të shitjes së inputeve të papërpunuara, e as në fazat më të avancuara ku krijohet vlera më e madhe, pra produkte finale të diferencuara. Dallimi në mes të peshës në vlerë dhe numrit të produkteve është domethënës. Për shembull, në kategorinë e produkteve finale, numri i produkteve të eksportuara është relativisht i lartë (42%), por ato përbëjnë vetëm 39% të vlerës së eksportit. Kjo shpërfaq një lloj fragmentimi dhe mungese specializimi; Kosova eksporton një gamë të gjerë produktesh finale, por me vlera të ulëta mesatare për produkt. Në terma të “upstreamness” sipas Fally (2011),¹⁵ Kosova pozicionohet në mënyrë të ndërmjetme, duke mos arritur të kapitalizojë mjaftueshëm vlerën e shtuar që krijohet në segmentet finale. Kjo strukturë thekson nevojën për politika industriale që nxisin industritë prodhuese drejt produkteve më “downstream” (afër konsumatorit final), ku diferencimi dhe afërsia me konsumatorin krijojnë potencial shumë më të madh zhvillimi ekonomik.

Diversifikimi i eksporteve është i rëndësishëm si në nivel nacional ashtu edhe në nivel të firmës. Në të dyja rastet, diversifikimi shihet si mekanizëm për uljen e rrezikut operativ. Koncentrimi mund të jetë gjeografik (në tregje të kufizuara) ose në strukturën e produkteve të eksportuara (eksportet e përqëndruara në pak produkte). Një vend me strukturë eksporti të koncentruar në një numër të vogël tregjesh apo produktesh gjithmonë do të jetë më sensitiv karshi tronditjeve në tregjet globale. Raste të tilla ka shumë, kryesisht të lidhura me vendet në të cilat struktura e eksporteve dominohet nga industritë e lidhura me burimet natyrore. Në anën tjetër, për bizneset diversifikimi nënkupton zgjerim të të ashtuquajturave margjina të eksportit, intensive dhe ekstensive, respektivisht. Thënë thjeshtë, diversifikimi për bizneset nënkupton zgjerim të shitjeve në tregje ekzistuese, zgjerim të shitjeve në tregje të reja, me produkte ekzistuese apo me produkte të reja. Në thelb, diversifikimi u shërben bizneseve në disa drejtime: së pari, për të reduktuar rrezikun

nga lëkundjet e paparashikuara në tregjet eksportuese; së dyti, për të absorbuar lëvizjet në kërkesë, dhe në fund, për të siguruar stabilitet më të madh të të ardhurave. Strategjia e diversifikimit i bën bizneset më fleksibile, si dhe iu mundëson të shfrytëzojnë më mirë përparësitë e tyre konkurrese dhe të pozicionohen më fuqishëm në zinxhirët global të vlerës.

Të dhënat zyrtare tregojnë se bizneset në Kosovës shfaqin një shkallë të konsiderueshme të dinamizmit në tregjet eksportuese. Kjo shihet përmes shkallës së shtrirjes në tregje ekzistuese dhe në ato të reja, si dhe shtrirjes përmes produkteve ekzistuese dhe të reja. Të dhënat tregojnë se brenda dhjetë viteve Kosova ka rritur numrin e produkteve të eksportuara për 22.5%. Bizneset e Kosovës eksportojnë mesatarisht rreth 723 produkte në vit (në nivelin HS 4-shifrorë), duke dëshmuar një bazë të gjerë të ofertës së tyre (shih Tabelën në vijim). Nga këto, rreth 91 janë produkte të reja që hyjnë çdo vit në tregjet eksportuese, me një vlerë mesatare prej rreth €2.48 milionë. Megjithatë pjesëmarrja e produkteve të reja eksportuese në totalin e eksporteve mbetet modeste (rreth 0.58%), prania e tyre është një tregues i potencialit inovativ dhe përpjekjeve të vazhdueshme për të zgjeruar gamën eksportuese. Në anën tjetër, çdo vit mesatarisht dalin nga tregjet eksportuese rreth 74 produkte, 21 prej të cilave janë dalje të përhershme.

Nga kontekst të tregjeve, brenda 10 viteve Kosova e ka dyfishuar prezencën e saj gjeografike në tregjet eksportuese, me një rritje prej 104.2%. Çdo vit, rreth 24 tregje të reja futen në hartën eksportuese të Kosovës, me një vlerë mesatare eksporti prej rreth €1.83 milionë (shih më poshtë). Pesha e ulët e tregjeve të reja në totalin e eksporteve (0.46%) dhe daljet nga tregjet eksportuese – mesatarisht 16 në vit – dëshmojnë se konsolidimi në tregjet e reja kërkon kohë dhe investime të vazhdueshme.

15 Ndarja e produkteve në tri kategori sipas pozicionimit në zinxhirin e vlerës është bërë duke përdorur indikatorin “upstreamness” të Fally (2011), i cili është i përllogaritur në nivelin 6-shifror të produkteve të eksportuara sipas Nomenklaturës së Sistemit të Harmonizuar (HS). Kjo qasje mundëson vlerësimin e shtrirjes së eksporteve kosovare në spektrin të zinxhirit të vlerës.

● **Tabela 11.** Indikatorët e diversifikimit të eksporteve në Kosovë, 2015 - 2024

Përshkrimi	Mesatarja
Numri i produkteve të eksportuara	723
Numri i produkteve të reja të eksportuara	91
Vlera e produkteve të reja të eksportuara (€)	2,479,876
Pjesëmarrja e produkteve të reja të eksportuara në total (%)	0.58
Numri i daljeve të produkteve eksportuese	74
Numri i daljeve të përhershme të produkteve eksportuese	21
Numri i tregjeve eksportuese	106
Numri i tregjeve të reja eksportuese	24
Vlera e eksportit në tregjet e reja eksportuese (€)	1,834,498
Pjesëmarrja e tregjeve të reja eksportuese total (%)	0.46
Numri i daljeve nga tregjet eksportuese	16

Burimi: Doganat e Kosovës (2025)

Tabela në vijim paraqet detaje shtesë në kontekst të diversifikimit sipas produkteve të eksportuara për periudhën e analizuar. Numri i produkteve të eksportuara arrin kulmin në vitin 2024 me 799 produkte, ndërsa maksimumi i produkteve të reja të eksportuara brenda një viti arrin shifrën prej 115 artikujve me vlerë prej 4.4 milionë euro. Dinamizmi i tregtisë reflektohet edhe përmes daljeve, ku viti 2019 ka

shënuar numrin më të lartë të produkteve që dalin nga tregjet eksportuese (91 produkte). Në këtë kontekst, viti 2023 shënon numrin më të lartë të daljeve të përhershme (43 produkte). Në aspektin gjeografik, Shqipëria del të jetë tregu më i rëndësishëm me një mesatare vjetore prej 620 produktesh të eksportuara, e ndjekur nga Maqedonia e Veriut, Zvicra dhe Gjermania.

● **Tabela 12.** Diversifikimi sipas produkteve eksportuese, HS 4-shifrorë, 2015 - 2024

Përshkrimi	Vlerat
Numri më i madh i produkteve të eksportuara për një vit (në vitin 2024)	799
Numri më i lartë i produkteve të reja të eksportuara	115
Vlera më e lartë e eksportit në € e gjeneruar nga produktet e reja të eksportuara (viti 2017)	4,433,687
Numri më i lartë i produkteve të reja të eksportuara (viti 2020; rritje prej 5.8% krahasuar me vitin paraprak)	40
Numri më i lartë i produkteve që kanë dalur nga tregjet eksportuese (viti 2019)	91
Numri më i lartë i daljeve të përhershme të produkteve eksportuese (viti 2023)	43
Tregu më i madh i Kosovës sipas numrit të produkteve të eksportuara	Shqipëria
Numri mesatar i produkteve të eksportuara në Shqipëri (pasojnë Maqedonia e Veriut: 563; Zvicra: 506; Gjermania: 486)	620

Burimi: Doganat e Kosovës (2025)

Në kontekst të diversifikimit të tregjeve, tabela në vijim paraqet dinamikën e eksporteve të Kosovës për periudhën 2015 – 2024. Në total, Kosova ka eksportuar së paku një herë në 194 tregje, ndërsa viti 2024 shënon kulmin me 147 tregje aktive. Numri më i lartë i tregjeve të reja u regjistrua në vitin 2021 (39 tregje), ndërsa vlera më e lartë e eksporteve drejt tregjeve të reja u shënuar në vitin 2019 me rreth €9.7 milionë. I njëjti vit paraqet edhe numrin më të madh të daljeve nga

tregjet eksportuese (24 tregje). Ekspozimi i gjerë gjeografik shihet edhe në faktin që në katër vitet e fundit produktet kosovare kanë qenë të pranishme në 27 tregje të BE-së dhe në pesë tregjet e CEFTA-s, ndërsa mesatarisht çdo vit eksportohet në 67 tregje të tjera (jashtë rajonit dhe BE-së). Në kategorinë e tregjeve të tjera shihet rritje e vazhdueshme e prezencës së produkteve të Kosovës, me 107 tregje të mbuluara në vitin 2024.

● **Tabela 13.** Diversifikimi në tregjet eksportuese, 2015 - 2024

Përshkrimi	Vlerat
Numri total i tregjeve në të cilat Kosova së paku ka eksportuar një herë	194
Numri më i lartë i tregjeve eksportuese (viti 2024)	147
Numri më i lartë i tregjeve të reja eksportuese (viti 2021)	39
Vlera më e lartë e eksportit në € e gjeneruar nga tregjet e reja eksportuese (viti 2019)	9,722,035
Numri më i lartë i daljeve nga tregjet eksportuese (viti 2019)	24
Numri i tregjeve të BE-së me prezencë të produkteve të Kosovës (2021 - 2024)	27
Numri i tregjeve të CEFTA-së me prezencë të produkteve të Kosovës	5
Numri mesatar i tregjeve eksportuese jashtë rajonit dhe BE-së	67
Numri më i lartë i tregjeve eksportuese jashtë rajonit dhe BE-së (viti 2024)	107

Burimi: Doganat e Kosovës (2025)

Të dhënat e mbledhura nga anketa me biznese përgjithësisht dëshmojnë ato çfarë u thanë në analizën e diversifikimit të eksporteve bazuar në të dhënat zyrtare (shih Tabelën më poshtë). Edhe të dhënat e anketës tregojnë shkallë të lartë të dinamizmit në sektorin e eksporteve. Sipas të anketuarve, rreth 76.8% e eksportuesve raportojnë rritje të eksporteve gjatë periudhës 2022 – 2024. Kjo rritje lidhet me me faktorë të brendshëm të performancës: 29.3% e ndërmarrjeve ia atribuojnë rritjen e eksporteve përmirësimit të cilësisë së produktit, 28.8% çmimeve më konkurruese, 27.8% forcimit të marrëdhënieve me blerësit, dhe 13.2% përmirësimeve në

logjistikë e transport. Për më tepër, të dhënat tregojnë se 45.7% e kompanive kanë plasuar produkte të reja në tregjet ekzistuese, ndërsa 42.6% kanë hyrë në tregje të reja eksportuese. Shpërndarja e numrit të tregjeve të reja tregon se shumica e firmave janë zgjeruar në mënyrë modeste – kryesisht në 1 apo 2 tregje të reja – por ka edhe raste të zgjerimit agresiv, ku disa kompani kanë hyrë në 6, 8 apo deri në 10 tregje të reja brenda periudhës së analizuar. Nga ana tjetër, për 34.1% të bizneseve raportet tregtare zgjasim më shumë se katër vjet, gjë që dëshmon konsolidim të raporteve tregtare, ndërsa 13.9% raportojnë dalje nga tregjet e caktuara.

● **Tabela 14.** Diversifikimi nga perspektiva e bizneseve, 2022 - 2024

Përshkrimi	Përqindja
Kompanitë që raportojnë rritje të eksporteve	76.8
Kompani të të cilat kanë plasuar produkte të reja në tregjet eksportuese	45.7
Kompanitë të cilat kanë shtrirë aktivitetin e tyre në tregje të reja eksportuese	42.6
Kompanitë që operojnë më shumë se katër vjet në tregjet eksportuese	34.1
Kompanitë që kanë dalur nga tregje të caktuara eksporti	13.9

Burimi: Riinvest (2025)


3.2 Rrjetet dhe rëndësia e tyre në rritjen e eksporteve

Rrjetet luajnë një rol thelbësor në aftësinë e bizneseve për t'u zgjeruar në tregjet ndërkombëtare. Literatura dallon disa lloje rrjetesh: rrjetet sociale (p.sh., lidhjet personale), rrjetet e biznesit (marrëdhëniet me blerës, furnitorë, nënkontraktorë, investitorë), dhe rrjetet institucionale (bankat, shoqatat e biznesit dhe institucionet publike). Literatura e ka konstatuar se rrjetet iu mundësojnë bizneseve – veçanërisht atyre të vogla dhe të mesme – të kompensojnë mungesën e burimeve të brendshme përmes qasjes më të lehtë në dije dhe informacione. Në anën tjetër, rrjetet kanë ndikim edhe në produktivitetin e firmave, e me këtë edhe në hyrjen dhe zgjerimin e bizneseve në tregjet e jashtme. Studimet empirike kanë vërtetuar se rrjetet shërbejnë si kanale të shkëmbimit të njohurive teknologjike, të informacioneve mbi kërkesën në tregjet e huaja dhe të praktikave të avancuara menaxheriale. Këto njohuri ulin kostot e hyrjes në tregjet e huaja, reduktojnë pasiguritë, dhe rrisin efikasitetin e brendshëm. Si rrjedhojë, firmat më të rrjetëzuara kanë më shumë gjasa

të eksportojnë, të hyjnë në më shumë tregje dhe të rrisin intensitetin e eksporteve të tyre.

Në rastin e Kosovës, rezultatet e anketës tregojnë se për t'u qasur tregjeve të eksportit bizneset mbështeten kryesisht në rrjete joformale me agjentët e tjerë në treg. Në mënyrë të veçantë, lidhjet me biznese – furnizues, nënkontraktorë, konkurrentë apo partnerë – përbëjnë kanalin kryesor të qasjes në tregjet e huaja. Pas rrjeteve me bizneset e tjera, për të iu qasur tregjeve eksportuese përqindja më e madhe e bizneseve të Kosovës mbështetet në kontaktet e krijuara përmes diasporës, e cila vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm si kanal ndërmjetësimi. Platformat e ndryshme online dhe panairët gjithashtu kontribuojnë në zgjerimin e bizneseve në tregjet ndërkombëtare. Në anën tjetër, rrjetet institucionale – përfshirë shoqatat e bizneseve dhe veçanërisht Qeverinë – rezultojnë të kenë ndikim shumë të kufizuar në qasjen e bizneseve në tregjet eksportuese. Vetëm 1.2% të bizneseve mbështeten në qeverinë e vendit si kanal rrjetizimi për eksport.

● **Figura 11.** Kanalet e rrjetëzimit dhe qasja në tregje eksporti



Anketa tregon se rrjetet me bizneset e tjera shërbejnë për referime dhe prezantime me klientë potencialë (27.33%). Një pjesë e konsiderueshme e bizneseve përdorin rrjetet me bizneset e tjera për shkëmbim të informacioneve mbi tregun (18.60%) dhe për bashkëpunim në zhvillimin e produkteve të reja (17.44%). Rreth 17% e bizneseve të anketuara përfitojnë nga fushatat e përbashkëta të marketingut dhe brendimit, ndërsa 13.95% theksojnë rëndësinë e transferimit të njohurive teknike. Një pjesë më e vogël e bizneseve mbështeten tek bizneset e tjera në treg me qëllim të sigurimit të kanaleve të distribuimit (5.23%).

Për shtrirjen e bizneseve jashtë, me interes të veçantë është të shihet në mënyrë specifike roli i kontakteve me diasporën. Figura më lartë tregon se rreth 24% e respondentëve konsiderojnë kontaktet me diasporën si mekanizëm i rëndësishëm për shtrirje në tregjeve të eksportit. Diaspora, sipas anketës,

ndihmon bizneset në faza të ndryshme të procesit të eksportimit: 28% e bizneseve raportojnë se diaspora ka qenë kyçe për hyrje në tregjet eksportuese (kalimin nga biznes vendor në biznes eksportues). Rreth 35% e bizneseve kanë deklaruar se diaspora e ka lehtësuar zgjerimin në tregje të reja, ndërsa 32% kanë deklaruar se janë mbështetur në diasporën për rritjen e shitjeve në tregjet ekzistuese. Roli i diasporës ka qenë i kufizuar në rikthimin e firmave në tregje nga të cilat ishin larguar më herët (5%).¹⁶

3.3 Burimet njerëzore dhe teknologjike

Në procesin e zgjerimit në tregjet e huaja, rol vendimtarë luajnë teknologjia dhe burimet njerëzore. Literatura

16 Në pyetjen mbi rolin e diasporës si instrument rrjetësimi, të anketuarit kanë dhënë përgjigje në më shumë se një alternativë. Andaj, edhe përqindjet nuk janë të barabarta me 100%.

ka dëshmuar se përdorimi i paisjeve të avancuara dhe teknologjive moderne i bën firmat më efikase, ul kostot dhe rrit cilësinë e produkteve, duke përmirësuar produktivitetin dhe duke i bërë më konkurruese në tregjet ndërkombëtare. Njëjtë, një fuqi punëtore me shkathtësi të avancuara, e trajnuar mirë dhe me njohuri praktike, u mundëson firmave të përshtaten me kërkesat e tregjeve të huaja dhe të jenë inovative. Në përgjithësi, kjo rritje e produktivitetit ndikon në uljen e kostove të hyrjes në tregjet e jashtme dhe rrit gjasat që bizneset të mbijetojnë dhe të zgjerojnë aktivitetin e tyre eksportues.

Të dhënat e anketës tregojnë se pesha specifike e teknologjisë dhe e burimeve njerëzore vazhdimisht po vjen duke u rritur. Parashikimet për vitin 2026 e dëshmojnë qartë këtë trend. Tabela 15 tregon shkallën e investimeve të bizneseve kosovare

në Hulumtim dhe Zhvillim (R&D). Edhe pse niveli aktual i investimeve mbetet relativisht i ulët në terma absolutë, prirjet janë pozitive dhe tregojnë rritje të vazhdueshme të vetëdijes për rëndësinë e investimeve në R&D dhe në inovacione. Veçanërisht, bie në sy fakti që eksportuesit investojnë më shumë se jo-eksportuesit, si në përqindje të kompanive që raportojnë investime, ashtu edhe në vlerat maksimale të investuara.


Për t’iu qasur tregjeve të jashtme, eksportuesit mbështeten veçanërisht në zhvillimin e produkteve apo shërbimeve të reja (shih figurën 12). Gjithashtu, të dhënat e anketës tregojnë për shkallë të lartë të konkurrueshmërisë të eksportuesve në tregjet ndërkombëtare. Si rrjedhojë e kësaj të fundit bizneset eksportuese në mesatare kanë raportuar shkallë më të ulët ndërprerjes së linjave të prodhimit në krahasim me ato jo-eksportuese.

● **Tabela 15.** Investime e eksportuesve dhe jo-eksportuesve në hulumtim dhe zhvillim

Përshkrimi	Viti	Eksportuesit		Jo-eksportuesit	
		%	Vlera max. (€)	%	Vlera max. (€)
Investimet në R&D	2024	25.58	800,000	24.11	50,000
	2025	27.13	150,000	23.40	70,000
	2026	27.91	200,000	24.11	100,000

Burimi: Riinvest (2025)

● **Figura 12.** Zhvillimet teknologjike në bizneset eksportuese dhe jo-eksportuese



Burimi: Riinvest (2025)

Në kontekst të teknologjisë, rezultatet e anketës tregojnë një dallim të theksuar midis eksportuesve dhe jo-eksportuesve në marrjen e certifikimeve ndërkombëtare të produkteve. Mbi 32% e eksportuesve posedojnë certifikime, krahasuar me vetëm rreth 13% të jo-eksportuesve. Kjo diferencë sugjeron se bizneset që synojnë tregjet e huaja janë më të prira të investojnë në standarde ndërkombëtare për të plotësuar kërkesat e tregjeve dhe për të rritur besueshmërinë e produkteve të tyre. Sa i përket burimeve njerzore, të dhënat e anketës tregojnë se eksportuesit investojnë dukshëm më shumë në trajnim se sa jo-eksportuesit: 44.96% e bizneseve të anketuara eksportuese kanë ofruar trajnim, krahasuar me vetëm 22.70% e bizneseve jo-eksportuese. Eksportuesit

kanë nevojë për personel të shkathtë dhe të kualifikuar për të përmbushur standardet e tregjeve të huaja, për t'u përshatur më shpejt me teknologjitë e reja dhe për të menaxhuar kërkesat komplekse të zinxhirit global të vlerës. Të dhënat tregojnë edhe fushat ku përqëndrohet trajnimi i bizneseve eksportuese: mbi 60% e tyre investojnë në aftësi të lidhura me teknologjinë – në trajnime të përgjithshme në IT (51%) dhe ato profesionale në IT (10%) – çka tregon rëndësinë e digjitalizimit për operacionet bizneseve dhe shitjet e tyre në tregjet e huaja. Përveç kësaj, një pjesë e konsiderueshme e kompanive përqëndrohet në zhvillimin e shkathtësive menaxheriale (23%) dhe atyre për punë në ekip (12%).


3.4 Pengesat, faktorët e rritjes, dhe performanca institucionale

Në kuadër të edicionit të këtij viti të Forumit, Instituti Riinvest ka realizuar një anketë me bizneset eksportuese për të analizuar në detaje ekosistemin eksportues në Kosovë. Analiza përfshin identifikimin e pengesave, faktorëve të rritjes, intensitetin e marrëdhënieve eksportuese, përfitimet nga marrëveshjet tregtare ekzistuese, efikasitetin institucional, si dhe reformat e nevojshme për lehtësimin e tregtisë. Në këtë anketë janë përfshirë 129 biznese eksportuese (në mesin e afër 300 biznesesh të anketuara) me mostrim që pasqyrojnë madhësinë, strukturën gjeografike dhe përbërjen sektoriale të sektorit eksportues në vend.

Të dhënat nga anketa tregojnë që firmat eksportuese në Kosovë përballen me një kombinim kompleks barrierash të brendshme dhe të jashtme, të cilat mund të mos jenë të larta individualisht, por krijojnë një efekt të fortë kumulativ që rrit kostot dhe ul gatishmërinë e aftësinë konkurruese për zgjerim në tregjet ndërkombëtare.¹⁷

Barrierat më të larta lidhen me qasjen në tregje – gjetja e konsumatorëve dhe ndërmjetësuesve – duke sinjalizuar mangësi në marketingun ndërkombëtar, rrjetëzimin dhe diplomacinë ekonomike. Kostot e zgjerimit në tregjet eksportuese dhe kostot e prodhimit sugjerojnë se firmat eksportuese operojnë me margjina të kufizuara dhe me presion të lartë financiar, ndërsa kërkesat për përmbushjen e stan-

● **Figura 13.** Pengesat kryesore për zgjerim në tregjet eksportuese



Burimi: Riinvest (2025)


17 Në figure janë të paraqitura pengesat kryesore të eksportuesve në shkallë intensiteti nga 20 deri në 100 ku sa më i lartë intensiteti aq më e madhe pengesa.

dardeve dhe rregulloreve tregojnë se harmonizimi me standardet e BE-së mbetet sfidë strukturore që kufizon hyrjen në tregje me vlerë të lartë. Barrierat jo-tarifore shfaqen më problematike sesa tarifat që tregton se sfidat mund të jenë më shumë administrative dhe rregullative (standardet, licencat dhe procedurat komplekse) se sa fiskal. Nga ana tjetër, barrierat e brendshme si ekspertiza e stafit dhe mungesa e punëtorëve të kualifikuar (rreth janë pengesa të rëndësishme, por jo dominuese, çka sugjeron se kapacitetet menaxheriale nuk janë problemi kryesor, por amplifikohen nga sfidat e jashtme. Në tërësi, profili i barrierave tregon një sektor privat që ka aspirata eksportuese, por operon në një ekosistem jo shumë mbështetës, ku mungesa e informacionit të tregut, kostot e larta të certifikimit dhe sfidat e lidhjes me tregjet e jashtme krijojnë pengesa të shumta të nivelit të moderuar-të lartë. Kjo situatë prodhon një efekt zinxhir që e bën konkurrencën ndërkombëtare të vështirë dhe kërkon qasje të integruar politike për reduktimin e barrierave jo-tarifore, rritjen e standardizimit dhe përmirësimin e infrastrukturës së eksportit.

Një aspekt i rëndësishëm që lidhet me këto sfida është fakti se barrierat strukturore dhe kostot e larta operative nuk ndikojnë vetëm në zgjerimin e tregjeve, por edhe në adoptimin e praktikave të qëndrueshme dhe efikase nga firmat eksportuese. Mungesa e investimeve në energji të ripërtërishme dhe vështirësitë për t'u integruar në tregun e hapur të energjisë janë pasojë e një ekosistemi që nuk ofron mbështetje adekuatë për modernizim dhe rritje. Kështu, sfidat e menaxhimit të kostove dhe harmonizimit me standardet ndërkombëtare lidhen ngushtë me kapacitetet e kufizuara për të përballuar presionet e tregjeve të jashtme, duke treguar se çështjet ekonomike, teknologjike dhe mjedisore janë të ndërvarura dhe ndikojnë drejtpërdrejt në konkurrueshmërinë e firmave eksportuese. Pjesa dërrmuese e firmave eksportuese (rreth 85 për qind) në Kosovë ende nuk përdorin burime të ripërtërishme të energjisë. Kjo tregon se tranzicioni energjetik në sektorin eksportues është ende në fazë shumë të hershme, gjë që në afat të mesëm mund të bëhet pengesë për konkurrueshmërinë, sidomos në tregjet e BE-së ku kërkesat për dekarbonizim dhe gjurmë karboni po rriten vazhdimisht. Gjithashtu, sipas të dhënave të anketës me biznese, një numër i vogël (rreth 16%) i firmave eksportuese kanë kaluar në tregun e hapur të energjisë elektrike ndërsa shumica dërrmuese vazhdojnë të furnizohen në tregun energjetik vendor me çmime të rregulluara. Për firmat që kanë kaluar në tregun e hapur të energjisë, implikimet financiare janë të konsiderueshme. Ato raportojnë se kostot e prodhimit rriten

mesatarisht me rreth 30 përqind si rezultat i daljes në treg të hapur. Kjo e dhënë shpjegon ndoshta pse shumica e bizneseve në vend hezitojnë të kalojnë në tregun e hapur; rritja e menjëhershme e kostove të energjisë elektrike i bën jokonkuruese bizneset eksportuese, sidomos ato që operojnë me margjina të ulëta të profitit.

● **Figura 14.** Faktorët e rritjes së eksporteve në tregjet ekzistuese




Burimi: Riinvest (2025)

Në anën tjetër, të dhënat nga anketa tregojnë se rritja e eksporteve në tregjet ekzistuese gjatë vitit 2025 tek një numër i madh eksportuesish lidhet kryesisht me faktorë të brendshëm të firmave, të cilët kanë forcuar pozitën e tyre konkurruese (figura 14). Përmirësimi i cilësisë së produktit, i raportuar nga numri më i madh i firmave të intervistuar, duket të jetë arsyeja kryesore për rritjen e eksporteve, duke konfirmuar se eksportuesit kosovarë janë duke investuar në përmirësimin e standardeve, teknologjisë së prodhimit dhe proceseve të kontrollit të cilësisë. Kjo gjetje është në përputhje me analizat paraprake mbi sfidat e certifikimit dhe standardizimit; edhe pse standardet mbeten një barrierë strukturore, bizneset që arrijnë të përshtaten dhe të rrisin cilësinë arrijnë të përfitojnë drejtpërdrejt në tregjet ndërkombëtare. Për më tepër, numri i konsiderueshëm prej tyre raportojnë se rritja e eksporteve është nxitur nga çmime më konkurruese, gjë që sugjeron se pjesa e ndërmarrjeve eksportuese ende operon në segmente të tregut ku konkurrenca e çmimeve mbetet përcaktuese. Kjo lidhet me faktin se struktura e eksporteve dominohet nga produkte bazike dhe mallra me vlerë të ulët të shtuar ku diferencimi përmes cilësisë nuk është gjithmonë i mjaftueshëm, dhe presioni mbi

çmimet mbetet i lartë. Po aq të rëndësishme janë edhe marrëdhëniet e përmirësuara me blerësit, gjë që konfirmon se diplomacia ekonomike, rrjetëzimi tregtar dhe prania në panaire dhe aktivitete promovuese janë faktorë që ndikojnë në suksesin eksportues. Ndërkaq, një numër më i vogël theksojnë përmirësimet në logjistikë dhe transport si faktorë nxitës në rritjen e eksporteve.

Megjithatë, një numër i vogël i eksportuesve kanë raportuar se në tri vitet e fundit kanë rënë eksportet e tyre dhe kryesisht si rezultat i faktorëve të jashtëm, ku firmat individuale kanë pak hapësirë të ndikojnë. Ulja e kërkesës në tregjet e synuara del si arsyeja kryesore për rënien e eksporteve. Ky rezultat është plotësisht në linjë me vlerësimet makroekonomike të FMN-së dhe Bankës Botërore, të cilat theksojnë dobësimin e aktivitetit ekonomik në Eurozonë – sidomos në Gjermani, që mbetet një nga destinacionet kryesore të eksporteve kosovare në Evropë.

● **Figura 15.** Arsyet e rënies së eksporteve në tregjet ekzistuese




Burimi: Riinvest (2025)

Një tjetër faktor i rëndësishëm është rritja e konkurrencës në tregjet e synuara, e cila tregon se produktet kosovare përballen me presion të shtuar nga prodhues të tjerë rajonalë dhe ndërkombëtarë. Kurse pjesa tjetër theksojnë rritjen e kostove të prodhimit si arsye për rënien e eksporteve, një gjetje që lidhet ngushtë me strukturën e inputeve dhe varësinë nga importet. Çmimet e larta të lëndëve të para, kostot e energjisë dhe vështirësitë në sigurimin e inputeve cilësorë rrisin dukshëm kostot për firmat që tashmë operojnë me margjina të ngushta.

Një pjesë më e vogël, por e rëndësishme e firmave raportojnë rritjen e barrierave tarifore dhe jo-tarifore, çrregullimet në zinxhirët e furnizimit dhe ulje të kapaciteteve të prodhimit, shpesh të lidhura me mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar. Ky është një trend që prej vitesh po vë në pah sfidat strukturore të ekonomisë Kosovare; migrimi, mungesa e profileve profesionale dhe vështirësia për të gjetur punëtorë me aftësi teknike ul fleksibilitetin prodhues të firmave eksportuese, duke kufizuar aftësinë e tyre për të përballuar kërkesën dhe për të mbajtur ritmin e porosive ndërkombëtare.

● **Figura 16.** Intensiteti i marrëdhënieve eksportuese me partnerët tregtar




Burimi: Riinvest (2025)

Një fenomen shqetësues, gjithnjë duke u mbështetur në të dhënat e anketës, është se një numër i madh i eksportuesve nuk arrijnë të sigurojnë marrëveshje kontraktuale me partnerët e tyre për periudha më të gjata se tre vjet (figura 16). Gati gjysma e ndërmarrjeve raportojnë se marrëdhëniet e tyre me klientët ndërkombëtarë zgjasin nga 0 deri në 3 vjet, ndërsa një e katërta zhvillojnë eksporte njëherëshe, që tregojnë hyrje sporadike në tregjet e jashtme dhe vështirësi në sigurimin e porosive të përsëritura. Kjo reflekton një nivel të lartë pasigurie në marrëdhëniet tregtare, i cili kufizon mundësitë për planifikim afatgjatë dhe investime në kapacitete të reja. Për më tepër, një e katërta e bizneseve vazhdojnë të mbështeten në dërgesa të njëherëshe, duke treguar një strukturë të brishtë të marrëdhënieve me partnerët tregtarë dhe duke ulur parashikueshmërinë e aktivitetit të tyre ekonomik.

Kjo prirje e marrëdhënieve relativisht afatshkurtra reflektohet edhe në faktin se gjatë tre viteve të fundit një pjesë e firmave janë tërhequr nga të paktën një treg eksportues. Shkaqet kryesore lidhen me kërkesën e ulët dhe kufizimet financiare, ndërsa në disa raste përmenden edhe konkurrenca e lartë, problemet me pagesat dhe tarifatat apo barrierat jo-tarifore. Këto gjetje sugjerojnë se tërheqja zakonisht është rezultat i kushteve të pafavorshme të tregut.

● **Figura 17.** Arsyet e tërheqjes nga tregjet e eksportit




Burimi: Riinvest (2025)

Pavarësisht sfidave, aranzhmanet tregtare qofshin ato me tregje rajonale apo individuale, përfitimet janë evidente. Sipas bizneseve eksportuese, jo të gjitha marrëveshjet tregtare peshojnë; në krye të listës qëndrojnë CEFTA dhe Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Turqinë, të cilat vlerësohen si më të dobishmet nga firmat, falë qasjes më të lehtë në tregjet rajonale, kostove më të ulëta të transportit dhe barrierave të reduktuara tarifore (figura 18). MSA me Bashkimin Evropian vlerësohet gjithashtu pozitivisht, duke reflektuar peshën e tregut të BE-së për eksportet e Kosovës, edhe pse

standardet e larta teknike të këtij tregu kufizojnë potencialin e shfrytëzimit të plotë. Në të kundërt, marrëveshjet me ekonomitë më të largëta, si FTA me Mbretërinë e Bashkuar dhe skema GSP me SHBA-të, rezultojnë më pak të dobishme për eksportuesit kosovar. Përveç barrierave të zakonshme të certifikimit dhe standardizimit, një faktor i rëndësishëm mbetet distanca gjeografike, e cila rrit ndjeshëm kostot logjistike dhe bën që eksportet e Kosovës të mos jenë konkurruese në tregjet e largëta.


● **Figura 18.** Intensiteti i marrëdhënieve eksportuese me partnerët tregtar



Megjithatë, përfitimet që rrjedhin nga marrëveshjet tregtare nuk realizohen automatikisht; aftësia e firmave për t'i shfrytëzuar këto marrëveshje varet shumë nga faktorët institucionalë dhe infrastrukturorë në vend. Barrierat logjistike, procedurat doganore të ngadalta dhe kostot shtesë mund të reduktojnë ndikimin e marrëveshjeve tregtare, duke kufizuar potencialin e eksportuesve për të arritur tregjet rajonale dhe ndërkombëtare në mënyrë konkurruese. Kjo lidhet ngushtë me nevojën për reforma që përmirësojnë efikasitetin e procedurave dhe reduktojnë pengesat operacionale, duke rritur kështu mundësinë e shfrytëzimit të plotë të marrëveshjeve ekzistuese. Në figurën më poshtë, janë të ranguar sipas rëndësisë shtatë reforma të cilat sipas vlerësimeve të eksportuesve janë prioritare me ndi-

kimin më të madh në përmirësimin e aktivitetit eksportues lidhen kryesisht me infrastrukturën dhe efikasitetin doganor. Thjeshtësimi dhe digjitalizimi i dokumentacionit për eksport si dhe procesimi paraprak i eksporteve vlerësohen si masat me efektin më të madh të pritshëm. Ndërmarrjet theksojnë gjithashtu rëndësinë reduktimit të kontrolleve fizike si dhe rritjen e transparencës dhe parashikueshmërisë së procedurave doganore si reforma efektive por. Këto gjetje tregojnë se eksportuesit shohin digjitalizimin e shërbimeve doganore dhe efikasitetin doganor si faktor të rëndësishëm për uljen e kostove dhe eventualisht rritjen e konkurrueshmërisë së tyre. Pjese më madhe e tyre bie në sferën e mjedisit institucional qeveritar dhe agjencive përkatëse.

● **Figura 19.** Intensiteti i marrëdhënieve eksportuese me partnerët tregtar




Burimi: Riinvest (2025)

Vlen të theksohet se të dhënat mbi kohën e zhdoganimit sugjerojnë se procedurat kufitare janë relativisht efikase. Rreth 30 për qind e firmave eksportuese raportojnë se një dërgesë e zakonshme eksporti përpunohet brenda më pak se një ore, ndërsa 28 për qind të tjera e përfundojnë brenda 2–5 orësh. Megjithatë, një pjesë jo e vogël e eksportuesve përballen me vonesa më të gjata. Rreth 10 për qind e tyre raportojnë se zhdoganimi zgjat deri në 24 orë, dhe afërsisht 5 për qind se procedurat zgjasin më shumë se një ditë. Kjo shpërndarje e pabarabartë e kohëzgjatjes së procedurave kufitare tregon për një sistem që funksionon mirë në shumicën e rasteve, por që mbetet i paparashikueshëm për disa

lloje të eksporteve, duke krijuar kosto shtesë nga vonesat në dërgesa. Gjithsesi, vlerësimet e eksportuesve mbi efikasitetin e akterëve të përfshirë në procedurat kufitare tregojnë një performancë të kënaqshme, por jo të shkëlqyer, me dallime të dukshme mes institucioneve. Agjentët doganorë marrin vlerësimin më të lartë, duke u përceptuar si palët më efikasë në menaxhimin e procedurave të eksportit. Pas tyre renditen Policia Kufitare dhe Doganat e Kosovës, të cilat vlerësohen pozitivisht, por me një nivel pak më të ulët të efikasitetit.

● **Figura 20.** Efikasiteti i institucioneve në procedurat kufitare



Burimi: Riinvest (2025)

Në anën tjetër, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë rezultoi institucioni më pak efikas sipas ndërmarrjeve, duke reflektuar sfida tashmë të njohura në proceset inspektuese, certifikimet dhe kontrollet që shpesh zgjasin procedurat e eksportit. Në tërësi, vlerësimet sugjerojnë se efikasiteti ku-

fitar në Kosovë është funksional, por jo i uniformuar, dhe se me domosdoshmet janë përmirësimet në koordinimin institucional dhe thjeshtimin e procedurave mbeten thelbësore për lehtësimin e tregtisë dhe rritjen e konkurrueshmërisë eksportuese.

REFERENCAT

Agjencia e Statistikave të Kosovës ASK (2025). Repertori Statistikor i Ndërmarrjeve Ekonomike 2024. Prishtinë: ASK.

Agjencia e Statistikave të Kosovës ASK (2025). Të dhënat tremujore të PBB-së sipas metodës së shpenzimeve dhe statistikave të regjistrimit të bizneseve për vitin 2025. Prishtinë: ASK.

ASHAK (2023). Indeksi i Konkurrueshmërisë Globale për Kosovën (bazuar në metodologjinë e WEF). Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Banka Botërore (2025a). Perspektivat Globale Ekonomike: Qershor 2025. Uashington, DC: Banka Botërore.

Banka Botërore (2025b). Raporti Ekonomik i Rregullt për Ballkanin Perëndimor Nr. 28 (Vjeshtë 2025): Uashington, DC: Banka Botërore.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) (2025). Perspektivat Ekonomike Rajonale – Shtator 2025. Londër: EBRD.

Banka Qendrore e Kosovës (2024). Raporti i Stabilitetit Financiar. Prishtinë: BQK.

Banka Qendrore e Kosovës (2025). Raporti Vjetor 2024. Prishtinë: BQK.

Bruegel (2025). Plakja e Popullsisë në Evropë dhe Potenciali i Rritjes: Implikimet Makroekonomike. Bruksel: Bruegel.

Fally, T. (2011). On the Fragmentation of Production in the US. *University of Colorado mimeo*.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) (2025). Përditësimi i Perspektivës Ekonomike Botërore – Korrik 2025: Rimëkëmbje e Ngadaltë. Uashington, DC: FMN.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) (2025). Republika e Kosovës: Rishikimi i Katërt në kuadër të Marrëveshjes Stand-By; Komunikatë për Shtyp; Raporti i Stafit; dhe Deklarata e Drejtorit Ekzekutiv për Republikën e Kosovës. Uashington, DC: FMN.

German Economic Team (GET) (2025a). Impact of Electricity Market Liberalisation on Industrial Competitiveness in Kosovo. Berlin: German Economic Team.

German Economic Team (GET) (2025b). Energy Cost Mitigation Options for Businesses in Kosovo. Berlin: German Economic Team.

Holzner, M. (2025). Qëndrueshmëria Paradoksale e Ballkanit Perëndimor. Vjenë: Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiiw).

Instituti Riinvest (2023) Një Model i ri për rritjen e qëndrueshme ekonomike – dinamika e tregut të punës, sfidat aktuale dhe të ardhshme. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Instituti Riinvest (2023). Forumi Ekonomik 2023: Një Model i Ri për Rritje të Qëndrueshme Ekonomike. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Instituti Riinvest (2023b). Sektori i Kërkimeve dhe inovacioneve nga prizma e punëtorëve kërkimor dhe inovativ. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Instituti Riinvest (2024) Tejkalmi i kurthit të rritjes së pamjaftueshme dhe rritja e efikasitetit të investimeve Prishtinë: Instituti Riinvest.

Instituti Riinvest (2024b). Studim gjithëpërfshirës për identifikimin e boshllëqeve të aftësive në tregun e punës në sektorin e industrisë në Kosovë. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Instituti Riinvest (2024c). Studim kërkimor mbi dinamikat e korrupsionit nga ana e ofertës në Kosovë. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Instituti Riinvest (2025). Anketa e me biznese. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Instituti Riinvest (2025). Parashikimi Makroekonomik për Kosovën 2025. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Instituti Riinvest (2025b) Zhvillimet në kërkimet shkencore dhe inovacione 2023-2025. Prishtinë: Instituti Riinvest.

Komisioni Evropian (2025). Raporti i Progresit për Kosovën. Disponueshme në: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/127563ea-4c03-44a4-b56c-2d569afd86a5_en (qasje më: [14/11/2025]).

McKinsey & Company (2025). Pamja e Kushteve Ekonomike Globale – Shtator 2025. Nju Jork: McKinsey & Company.

OECD (2023). Indeksi i Politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2023. Paris: OECD Publishing.

OECD (2024). Pamja e Konkurrueshmërisë 2024: Politikat dhe Promovimi i Investimeve; Mjedisi i Biznesit. Paris: OECD Publishing.

OECD (2025). Tabela e Konvergjencës Ekonomike për Ballkanin Perëndimor. Paris: OECD Publishing.

Vienna Institute for International Economic Studies (wiiw) (2025). Parashikimi për Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE): Raporti i Parashikimeve të Pranverës 2025. Vjenë: wiiw.

Zyra e Regullatorit të Energjisë (ZRRE) (2025). Raporti Vjetor për Performancën e Tregut të Energjisë Elektrike 2024. Prishtinë: Zyra e Regullatorit të Energjisë së Republikës së Kosovës.

Shtojca 1: Metodologjia e përpilimit të Modelit Makroekonomik për Kosovën (FPP)

Hyrje

Modeli Makroekonomik për Kosovën (FPP) është një instrument analitik gjithëpërfshirës i cili synon të mbështesë institucionet publike në procesin e planifikimit dhe vlerësimit të politikave ekonomike. Ky model përdoret për të analizuar zhvillimet aktuale, për të bërë parashikime të bazuara në të dhëna statistikore, si dhe për të simuluar efektet që mund të kenë ndryshimet e politikave fiskale, monetare apo tregtare në ekonominë e Kosovës. FPP është pjesë e përpjekjeve për të krijuar një qasje të unifikuar, transparente dhe profesionale në analizën makroekonomike të vendit, duke e bërë politikëbërjen më të bazuar në evidenca.

Qasja metodike

Qasja metodike e përdorur për ndërtimin e FPP-së kombinon elemente të analizës statistikore, teorisë ekonomike dhe zhvillimeve aktuale. Fillimisht identifikohen faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, si konsumi, investimet, eksportet, remitancat, çmimet dhe politikat fiskale. Më pastaj ndërtohen marrëdhënie logjike dhe kuantitative ndërmjet tyre përmes ekuacioneve që shprehin lidhjet kauzale dhe të ndërsjella të variablave ekonomik. Ky proces mbështetet në të dhëna të standardizuara nga burime zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare, si Agjencia e Statistikave të Kosovës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Ministria e Financave, si dhe organizata ndërkombëtare si FMN dhe Banka Botërore. Në këtë mënyrë, sigurohet që rezultatet e modelit të jenë të krahasueshme, konsistente dhe të besueshme.

Struktura e modelit

Modeli është i ndarë në disa blloqe funksionale – sektorë institucional, që lidhen ndërmjet tyre dhe përbëjnë sektorët kryesorë të ekonomisë:

- Sektori real – përfshin produktin e brendshëm bruto (PVB), konsumin privat e publik, investimet, eksportet dhe importet. Ky sektor shërben si baza kryesore e modelit dhe përcakton aktivitetin ekonomik total;
- Sektori fiskal – përfshin të hyrat tatimore dhe shpenzimet qeveritare. Analiza e tij lejon vlerësimin e ndikimit të politikave buxhetore në rritjen dhe stabilitetin ekonomik;
- Sektori financiar – përfshin BQK-në, kreditimin nga bankat dhe trendin e depozitave në bankë ndërlidhur me burimet e financimit. Ky sektor ndihmon në analizimin e ndikimit të ndërmjetësimit financiar në ekonominë reale të Kosovës;
- Sektorin e jashtëm – që përfshin bilancin tregtar në mallra dhe shërbime, të hyrat parësore dhe dytësore, si dhe investimet direkte, portfolio, etj. Kjo, duke treguar efektin e këtij sektori në Ekonominë e Kosovës.

Procesi i përpilimit të modelit

Zhvillimi i modelit kalon në disa faza të ndërlidhura që sigurojnë saktësi, koherencë dhe zbatueshmëri praktike:

1. Mbledhja e të dhënave – përzgjedhja e burimeve zyrtare, harmonizimi dhe verifikimi i cilësisë së të dhënave;
2. Analiza e serive kohore – identifikimi i trendeve afatshkurta dhe afatgjata, si dhe cikleve ekonomike;
3. Ndërtimi i ekuacioneve kuantitative – krijimi i lidhjeve ndërmjet variablave përmes modeleve statistikore;
4. Kalibrimi dhe testimi i modelit – krahasimi i rezultateve me të dhënat reale për të garantuar përputhshmërinë empirike;
5. Simulimet dhe parashikimet – përdorimi i modelit për të parashikuar ecurinë e ekonomisë dhe për të testuar skenarë të ndryshëm.

Roli i modelit në politikëbërje

Modeli FPP është një mjet i rëndësishëm në mbështetjen e procesit të politikëbërjes dhe planifikimit fiskal. Ai mundëson:

- Hartimin e projeksioneve makroekonomike që përdoren në përgatitjen e buxhetit të shtetit;
- Vlerësimin e ndikimit të masave fiskale dhe reformave strukturore në ekonominë kombëtare;
- Analizimin e skenarëve alternativë për zhvillime të mundshme, si ndryshimet në fluksin e jashtëm financiar, përfshirë remitancat dhe flukset tjera;
- Forcimin e transparencës institucionale dhe përmirësimin e komunikimit me publikun dhe partnerët tjerë vendor dhe ndërkombëtarë.

Kufizimet dhe përmirësimet e ardhshme

Si çdo model ekonomik, FPP mbështetet në të dhëna të kufizuara dhe supozime të caktuara që mund të ndikojnë në saktësinë e parashikimeve. Në kontekst sektorial, përderisa të dhënat në dispozicion për sektorët financiar, fiskal dhe të jashtëm mundësojnë përpilimin e modelit përgjithësisht të qëndrueshëm, mungesa e të dhënave nga sektori real, ku më kryesorët janë: (i) mos publikimi i PVB-së me çmime konstante; (ii) mos publikimi i informatave mbi deflatorët; (iii) nevoja për shpalosje më të detajuar të indekseve të çmimeve, ndikojnë drejtpërdrejtë në saktësinë dhe qëndrueshmërinë e modelit ekonomik sipas qasjes së FPP-së.

Modeli është konceptuar si një proces dinamik që përditësohet rregullisht me të dhëna të reja, përmirësime metodike dhe analiza të avancuara. Përfshirja e komponentëve të rinj si dhe parashikimet afatgjata marrë parasysh skenarët bazik dhe programor, janë synime të fazave të ardhshme.

Përfundim

Modeli makroekonomik i Kosovës përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt profesionalizimit të analizës dhe planifikimit ekonomik, si një model i integruar dhe i bazuar plotësisht në identitete. Ai shërben si një urë midis politikëbërjes dhe analizës shkencore, duke e bërë procesin e vendimmarrjes më transparent dhe të bazuar në evidenca. Nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm, përpilimi i modelit ekonomik përmes qasjes së FPP-së do të vazhdojë të kontribuojë në ndërtimin e politikave të qëndrueshme ekonomike dhe rritjen e besueshmërisë publike.

